

Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani

Vlerësim i shkurtër i kthimeve pozitive dhe negative

Shkurt 2020





Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani

Vlerësim i shkurtër i kthimeve pozitive
dhe negative.

Shkurt 2020

Përmbajtja

Hyrje	4
Kompetenca e BE-së dhe ajo vendore sa i përket migracionit legal	5
Politikat liberale (por selektive) të Gjermanisë sa i përket migracionit të punës	6
Përfitimet dhe rreziqet e mundshme nga rrugët e migrimit legal	8
Deficiti në tregun e punës në Gjermani	10
Migrimi për punësim në Gjermani nga vendet e BE-së dhe jo të BE-së	13
Nxitja e migrimit për punë (të punëtorëve të kualifikuar dhe pakualifikuar) nga Ballkani Perëndimor	15
Sfondi sfidues i tregut të punës në Kosovë	18
Teprica e fuqisë punëtore për sektorë në Kosovë	21
Fuqia punëtore e Kosovës me sytë kah tregu gjerman për mundësi punësimi	23
Përfundimi dhe rekomandimet	27
Shtojcat	30

Ky raport është përgatitur nga Instituti GAP dhe është mbështetur nga Njësia Hulumtuese e Këshillit të Ekspertëve të Fondacioneve Gjermane për Integrimin dhe Migracionin (SVR). Njësia Hulumtuese e SVR-së ka këshilluar për qasje në të dhëna dhe ka siguruar mbështetje konceptuale dhe editoriale.

Hyrje

Përkundër rritjes së imigrimit nga vendet e BE-së dhe vendet jo të BE-së, fuqia punëtore në Gjermani mbetet e pamjaftueshme dhe aktualisht është në rekordin e ulët. Numri i vendeve të lira të punës ishte më i larti në tremujorin e fundit të vitit 2018, ndërsa kostoja e vendeve të paplotësuar të punës u rrit shumë.¹ Për ta luftuar këtë trend, Gjermania prezantoi rrugë të ndryshme ligjore për të tërhequr fuqinë punëtore të huaj, për të menaxhuar rënien demografike dhe për të zvogëluar migracionin e parregullt. Në vitin 2015, Gjermania hapi tregun e punës për gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor si përgjigje ndaj rregullores së re të miratuar që kufizonte azilkërkuesit e pabazuar. Kjo e ashtuquajtur Rregullore e Ballkanit Perëndimor (RRBP), e parashikuar në nenin 26.2 të Urdhëresës së Punësimit (Beschäftigungsverordnung), nuk specifikoi ndonjë kusht për ndonjë shkathtësi të caktuar, e si rrjedhojë, i ftonte të dyja kategoritë e punëtorëve, të kualifikuar dhe të pa kualifikuar në tregun gjerman të punës mbi bazën e një oferte të vlefshme pune.

Gjatë vitit 2015, norma mesatare e papunësisë në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ishte rreth 21.2 përqind.² Prej vitit 2016 deri në vitin 2018, Agjencia Federale Gjermane e Punësimit (AFP) shqyrtoi mbi 200,000 aplikime për punësim nga vendet e Ballkanit Perëndimor (BP) me një normë aprovimi prej më shumë se 80 përqind.³ Sidoqoftë, në më pak se një e treta e këtyre rasteve (44.093) ishte lëshuar një vizë pune sipas ligjit gjerman të qëndrimit.

RRBP-ja u kritikua se ishte e njëanshme për nga natyra – se kryesisht u shërbente nevojave të tregut të punës të Gjermanisë.⁴ Ndërsa efekti i RRBP-së në dinamikën e migracionit dhe tregun e punës u diskutua gjerësisht midis studiuesve dhe politikë-bërësve në Gjermani,⁵ kishte pak ose aspak komunikim në lidhje me këtë rregullore në vendet e Ballkanit Perëndimor. Duke qenë dëshmitarë të eksodit të punëtorëve, debatet u shfaqën brenda vendeve të targetuara në lidhje me përfitimet sociale që ato realizonin dhe kostot e migracionit të punës. Kjo gjë pritet të intensifikohet pasi “Ligji mbi Imigracionin e Kualifikuar” për shtetasit jo të BE-së që është miratuar në Gjermani, do të hyjë në fuqi në mars të vitit 2020 si ligji më liberal për imigracionin deri më tani.

Që nga viti 2015, Kosova vazhdon të ketë si numrin më të madh të aplikacioneve të paraqitura në AFP duke përdorur RRBP-së dhe numrin më të madh të vizave të lëshuara. Me gjithë migracionin e lartë, Kosova ka normën më të lartë të papunësisë dhe PBB-në më të ulët për kokë banori nga të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo tepriçë e fuqisë punëtore e përcjellë edhe me rritjen e perspektivave të imigracionit paraqet kërcënim si dhe mundësi për ekonominë e Kosovës. Ky studim do të tregojë potencialin e tregjeve plotësuese të punës ndërmjet Kosovës dhe Gjermanisë, duke i analizuar nevojat e tregut për sektorët dhe shkathtësitë specifike dhe do të ofrojë shembuj të rrugëve ligjore në dobi të të dyja palëve.

Studimi synon t’u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme: Cilat janë efektet e kërkesës së Gjermanisë për fuqi punëtore për Kosovën? Sa njerëz janë larguar nga vendi deri më tani? Çfarë deficiti të fuqisë punëtore po plotësojnë në Gjermani emigrantët nga Kosova? A do të nxisë ligji i ri migracion të mëtutjeshëm të fuqisë punëtore nga Kosova? A është vala e migracionit e mirë apo e keqe për ekonominë e Kosovës? Dhe çfarë duhet të bëjnë të dyja qeveritë për ta menaxhuar korridorin e migracionit të fuqisë punëtore ndërmjet vendeve në mënyrë të dobishme dhe të qëndrueshme?

1 Valentina Romei. Vendet e paplotësuar të punës në Gjermani i shtyjnë shifrat e eurozonës deri në rekord. Financial Times (2019). Burimi: <https://on.ft.com/2TVpSB8>

2 Isilda Mara dhe të tjerët. Migracioni i punës ndërmjet Bosnje dhe Hercegovinës dhe Austrisë. Qendra për Hulumtime dhe Studime (2019). Burimi: <https://bit.ly/2ZSZMiX>

3 Referoju Shtojcës 2.


4 Jessica Bither dhe Astrid Ziebarth. Krijimi i rrugëve ligjore për reduktimin e imigrimit të parregullt? Çfarë mund të mësojmë nga “Rregullorja për Ballkanin Perëndimor” e Gjermanisë. Grupi i Strategjisë së Migracionit mbi Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar (2018). Burimi: <https://bit.ly/37elBKT>

5 Po aty.

Kompetenca e BE-së dhe ajo vendore sa i përket migracionit legal

BE ka bërë përpjekje vazhdimisht dhe gradualisht që t'i harmonizojë politikat e migracionit midis shteteve anëtare; megjithatë, këta të fundit kanë qenë ngurrues që të heqin dorë nga kontrolli mbi imigrimin e shtetasve nga vendet jo të BE-së, dhe veçanërisht migracionin e fuqisë punëtore, pasi që kjo lidhet me politikat e tyre ekonomike.⁶ Kështu që, në pjesën më të madhe, shtetet anëtare mbeten autoriteti qendror në hartimin dhe zbatimin e politikave të imigracionit.

Arsyetimi kryesor që përdoret për hartimin e politikave të migracionit të punës është përgjigja ndaj nevojave të tregut të punës.⁷ Shtetet anëtare i adresojnë kërkesat e tregut të punës përmes kanaleve të ndryshme të migracionit të punës. Duke pasur parasysh që secili shtet anëtar ka nevoja të ndryshme, qasjet në lidhje me hartimin e politikave të migracionit ndryshojnë mes shteteve anëtare të BE-së. Disa shtete, si Suedia, përdorin një qasje liberale dhe 'me fokus tek punëdhënësi' që 'nuk varet nga shteti'.⁸ 'Me fokus tek punëdhënësi' tregon se fuqia për të rekrutuar punëtorë u takon punëdhënësve pa shumë ndërhyrje nga qeveria. "Që nuk varet nga vendi" i referohet nocionit që punëdhënësit janë të lirë të rekrutojnë punëtorë nga kudo në botë pa angazhimin e qeverisë në marrëveshje preferenciale me shtete specifike që nuk janë në BE. Prandaj, një qasje specifike për vendin përcakton një grup të privilegjuar të vendeve të treta nga të cilat do të duhej të rekrutohej fuqia punëtore. Vende si Gjermania, Spanja, Italia dhe Franca, mbështeten kryesisht në metodat 'me fokus tek shteti' dhe 'vendet e caktuara'.⁹ Këto shtete përdorin një kombinim të listave me profesione ku ka mungesa, testet e tregut të punës dhe kuotat për caktuar kushte sipas të cilave mund të rekrutohen punëtorë të huaj me kualifikime të ulëta dhe të mesme. Për ta arritur këtë, disa shtete lidhin marrëveshje bilaterale me vende të caktuara që nuk janë anëtare të BE-së me qëllim të rekrutimit të punëtorëve.



6 Neni 79(1) i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFEU) kërkon një politikë të përbashkët të imigracionit për të siguruar menaxhimin e flukseve të migracionit. Në nenin 5 të të njëjtit nen thuhet se "[k]y nen nuk ndikon në të drejtën e shteteve anëtare për të përcaktuar vëllimet e pranimi të shtetasve të vendeve të treta që vijnë nga vendet e treta në territorin e tyre për të kërkuar punë". Burimi: <https://bit.ly/2St3jCV>

7 Njësia e Hulumtimeve e Këshillit të Ekspertëve (Njësia Hulumtuese e SVR-së)/Migration Policy Institute Europe (MPI Europe). Migrimi ligjor për punë dhe trajnime: Opsionet e mobilitetit për në Evropë për ata që nuk kanë nevojë për mbrojtje (2019). Burimi: <https://bit.ly/354XNcz>

8 Po aty.

9 Po aty.

Politikat liberale (por selektive) të Gjermanisë sa i përket migracionit të punës

Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), Gjermania ka një nga politikat më liberale të migracionit të punës në mesin e vendeve të OECD-së, veçanërisht për emigrantët me arsim të lartë.¹⁰ Direktiva e Kartës Blu të BE-së është një mundësi e migracionit ligjor në mbarë BE-në për migrantët e kualifikuar (me certifikatë kualifikimi profesional më të lartë) me oferta pune që paguhen zakonisht 1.5 herë më shumë se paga mesatare e përgjithshme vjetore në shtetin anëtar.¹¹ Brenda kësaj Direktive të BE-së, shtetet anëtare mund të hartojnë udhëzimet e tyre të Kartës Blu, siç është numri i lejeve të lëshuara dhe kohëzgjatja për të cilën ato janë të vlefshme.¹² Përveç kësaj, ligji gjerman i qëndrimit, si ai i shumë shteteve të tjera anëtare të BE-së, parashikon rregulla dhe procedura konverguese për kategoritë e tjera të punëtorëve me kualifikime të larta, d.m.th. për hulumtuesit dhe personelin mësimor ose shkencor në poste të shquara, si dhe për të vetëpunësuarit dhe punëtorët e kualifikuar qoftë me arsim akademik ose atë profesional.

Politikat e migracionit të punës në Gjermani për punëtorë me kualifikime të ulëta dhe të mesme që nuk janë nga vende të BE-së, përbëhen nga politika, programe dhe pilot projekte të ndryshme specifike për vendin, por më e rëndësishmja prej të cilave është e ashtuquajtura Rregullorja për Ballkanin Perëndimor (RRBP), e prezantuar në vitin 2015. Ajo u jep qasje më të lehtë në tregun gjerman të punës, punëtorëve të të gjitha niveleve të kualifikimeve nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.¹³ Kjo rregullore është paraparë të skadojë në dhjetor të vitit 2020, megjithatë, gjersa politikë-bërës të ndryshëm gjermanë po vlerësojnë këtë politikë si sukses, dhe për këtë arsye, po e mbrojnë fort zgjatjen e kësaj rregulloreje përtej vitit 2020.¹⁴ Arsyetimi kryesor i RRBP-së ishte kontrolli i migracionit, megjithëse disa politikanë identifikuan përfitimet e mundshme që rrjedhin nga RRBP-ja sa i përket adresimit të nevojave të tregut të punës të Gjermanisë.¹⁵ Para vitit 2015, numri i madh i azilkërkuesve pa bazë nga vendet e BP-së krijoi presion për t'i shpallur ato vende si "vende të sigurta të origjinës",¹⁶ duke i përshpejtuar dhe shkurtuar procedurat e azilit si dhe duke zvogëluar shanset për marrjen e statusit të azilit. Si kompromis për kufizimin e fluksit të migracionit për azil, Gjermania hapi tregun e punës për vendet e BP-së përmes rregullores të njohur si neni 26.2 i "Urdhërësës së Punësimit". Rregullorja është unike sepse aty nuk u vendos asnjë kufizim në lidhje me shkathtësinë ose nivelin e kualifikimit për sa kohë që ekziston një ofertë e vlefshme punësimi. Aplikimi i nënshtrohet një kontrolli me prioritet, ku punëdhënësit gjermanë duhet të dëshmojnë se asnjë punonjës vendor, i BE-së ose punëtor me status të njohur refugjati nuk mund të plotësojë vendin e lirë (shiko rubrikën 1). Para RRBP-së, punëtorë me kualifikim të ulët dhe të mesëm kishin qasje shumë të kufizuara në tregun gjerman të punës. Që nga koha kur hyri në fuqi rregullorja, mijëra punëtorë nga vendet e BP-së kanë emigruar në Gjermani.

10 Këshilli i Ekspertëve të Fondacioneve Gjermane mbi Integrimin dhe Migrimin. Vendet e Emigracionit: Gjermania në një Krahësim Ndërkombëtar (2015). Burimi: <https://bit.ly/39hRS6W>

11 Direktiva e Këshillit 2009/50/EC e datës 25 maj 2009. Mbi kushtet e hyrjes dhe të qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllime të punësimit me kualifikime të larta. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (2009). Burimi: <https://bit.ly/35Rkv8M>

12 Lorenz Böttcher. Ligji për Qëndrimin, Aktivitetin Ekonomik dhe Integrimin e të Huajve në Territorin Federal. Arkivi Gjerman i Ligjit (2018). Burimi: <https://bit.ly/2Mkis5x>

13 Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia.

14 Jessica Bither dhe Astrid Ziebarth, Krijimi i rrugëve ligjore për reduktimin e migrimin të parregullt? Çfarë mund të mësojmë nga "Rregullorja për Ballkanin Perëndimor" e Gjermanisë. Grupi i Strategjisë së Migracionit mbi Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar. (2018). Burimi: <https://bit.ly/37elBKT>

15 Po aty.

16 Zyra e Komisionerit të Përgjithshëm për Refugjatët dhe Persona pa Shtetësi thotë se "vendi i origjinës konsiderohet të jetë i sigurt nëse përgjithësisht dhe në mënyrë të vazhdueshme nuk ka asnjë përndjekje sipas Konventës së Gjenevës ose rrezikut të pësojë dëm serioz, sipas përkufizimit të mbrojtjes plotësuese". Zyra e Komisionerit të Përgjithshëm për Refugjatët dhe Personat pa Shtetësi. Burimi: <https://bit.ly/2QpDsci>

Përveç RRBp-së, Gjermania ofron leje pune përmes disa marrëveshjeve ndërqeveritare. Për shembull, Gjermania ka marrëveshje qeveritare me Bosnje-Hercegovinën (BeH), Maqedoninë e Veriut, Serbinë dhe Turqinë lidhur me migracionin e fuqisë punëtore. Punëtorët me seli në këto vende mund të dërgohen për punë dhe të punësohen në Gjermani me kontrata pune për një periudhë të kufizuar kohore nën kuota fikse.¹⁷ Sidoqoftë, numri i punëtorëve të dërguar për punë është modest: Në vitin 2018 kishte gjithsej 1,748 punonjës nga BeH, 2,983 nga Serbia, 139 nga Maqedonia e Veriut dhe 926 nga Turqia. Lloji i punës për të cilën janë rekrutuar përfshin: tokën, pylltarinë, minierat, prodhimin dhe përpunimin e metaleve, ndërtimin, etj.¹⁸

Një tjetër iniciativë për të rritur fuqinë punëtore për sektor specifik është një marrëveshje ndër-organizatave ndërmjet Shërbimeve Ndërkombëtare të Vendosijes së Agjencisë Federale të Punësimit (ZAV) dhe Korporatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar GmbH (GIZ). Në vitin 2013, këto dy organizata filluan një projekt pilot të quajtur “Fitore e Trefishtë”, për ta zbutur mungesën e infermierëve të kualifikuar në Gjermani kundrejt tepriçës së infermierëve në vendet pjesëmarrëse dhe për të stimuluar ekonominë në vendet amë përmes dërgimit të remitencave.¹⁹ Vendet partnere aktuale janë Serbia, BeH, Filipinet dhe Tunizia. Këto vende kanë trajnime të ngjashme si infermierët gjermanë dhe shumë banorë tashmë janë disi të njohur me gjuhën. ZAV dhe GIZ punojnë së bashku për të përgatitur infermierët me trajnime intensive për gjuhë dhe ato teknike-profesionale për të siguruar një tranzicion të qetë kur të mbërrijnë në Gjermani.²⁰ Punëdhënësit pritët të paguajnë një tarifë prej 5,500 eurosh, së bashku me tarifat e transportit dhe të çertifikimit për çdo infermier(e) të punësuar përmes kësaj nisme.²¹ Janë më shumë se 2.600 infermierë projekti ‘Fitore e Trefishtë’ në Gjermani dhe studimet tregojnë se 92.6 përqind e tyre janë të kënaqur me rezultatin.²²

Rubrika 1. Procedurat për marrjen e një vize të punës përmes Rregullores për Ballkanin Perëndimor

Procesi fillon me një kontratë gjermane të punës, e ndjekur nga një termin për vizë në një ambasadë gjermane për të paraqitur dokumentet për shqyrtimin e besueshmërisë së kontratës dhe kryerjen e kontrolleve të verifikimit. Para se të lëshohet viza e punës, Agjencia Federale e Punësimit kryen testin e tregut të punës, duke përfshirë “kontrollin e prioritetit”: d.m.th. ku heton nëse një shtetas gjerman ose i BE-së, një i huaj me leje qëndrimi, një azilkërkues ose një individ me pezullim të përkohshëm të dëbimit që posedon një leje pune mund të jetë i disponueshëm për vendin e punës para këtij aplikuesi. Për më tepër, Ambasada konsultohet me autoritete të tjera në Gjermani, d.m.th., Zyra Federale e Administrimit dhe autoriteti lokal i të huajve, nëse janë përmbushur kriteret e përjashtimit (të tilla si kërcënimi i sigurisë, një kërkesë e mëparshme për azil ose përfitime të marra si azilkërkues). Pas miratimit nga Agjencia Federale e Punësimit dhe kur plotësohen të gjitha parakushtet e tjera, viza lëshohet.

¹⁷ Agjencia Federale e Punësimit (BA) (2018). Burimi: <https://bit.ly/ztobqMj>

¹⁸ Agjencia Federale e Punësimit (BA). Pëlqimi dhe refuzimi për të punuar për shtetasit e vendeve të treta. Me-satarja vjetore e punëtorëve me kontrata për punën bazuar në marrëveshjet ndërqeveritare. Burimi: <https://bit.ly/2kywLj3>

¹⁹ Sonja Alves Luciano et al. Rekrutimi i infermierëve nga jashtë në mënyrë të qëndrueshme. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) (2019). Burimi: <https://bit.ly/2lG29WF>

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

²² Po aty.

Urat nga Kosova për në Gjermani? Kanalet ligjore të migrimit për punë për shtetasit e Kosovës

Përveç RRBp-së, që përfshin Kosovën si një nga gjashtë vendet e BP-së, dhe dispozitat e përgjithshme për migracionin me kualifikim dhe me kualifikim të lartë në Ligjin e Qëndrimit, Kosova dhe Gjermania kanë tri marrëveshje ndërqeveritare të quajtura programi “Partneriteti i Shkathtësive”.²³ Një Memorandum Mirëkuptimi u nënshkrua në mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë dhe GLZ-it me tri shoqatat e biznesit në Gjermani, si vijon:

- Marrëveshja e parë u nënshkrua në vitin 2015 me një shoqatë biznesi të quajtur “Besa Foundation” që është kryesisht aktive në gastronomi dhe ndërtim.
- Marrëveshja e dytë u nënshkrua në vitin 2017 me “LBB – Shoqata e Ndërtuesve të Bavarisë” (Landesverband Bayerische Bauinnungen) aktive vetëm në ndërtim.
- Marrëveshja e fundit u nënshkrua në vitin 2018 me “UB – Shoqata e Biznesit Gjermano-Kosovar në Gjermani” që përfshin shumë profile: gastronomi, ndërtim, përpunim të drurit, infermieri, makineri. Përmes këtij projekti, të rinjtë nga Kosova janë përzgjedhur për të ndjekur një sistem të dyfishtë të arsimit dhe aftësisë profesionale (Ausbildung) në sektorë të ndryshëm në Gjermani. Ata kanë mundësinë të punojnë si praktikantë në kompanitë anëtare të shoqatave të lartpërmendura të vendosura në të gjithë Gjermaninë.

Falë atyre marrëveshjeve, gjatë viteve 2015 deri në 2017, 84 njerëz migruan në Gjermani për të ndjekur arsimin profesional, trajnimin dhe punën në gastronomi dhe infermieri. Në vitin 2018, 30 persona shtesë u larguan nga Kosova për qëllime punësimi në ndërtim, dhe gjatë vitit 2019, 27-të tjerë u punësuan në lëmin e infermierisë dhe të ndërtimit.²⁴

Kohët e fundit, janë shfaqur diskutime në lidhje me një marrëveshje tjetër bilaterale, e cila do të negociohet në vitin 2020 ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Kosovës dhe Agjencisë Federale të Punësimit të Gjermanisë në lidhje me programet dhe kualifikimet e migracionit të punës. Sidoqoftë, termat e negociatave nuk janë publikuar ende.²⁵

Përfitimet dhe rreziqet e mundshme nga rrugët e migrimit legal

Hapja e rrugëve më të gjera ligjore për migrantët me kualifikime të mesme dhe të ulëta, ndonëse jo gjithmonë, mundëson që disa migrantë t'i shmangin rreziqet e migrimit të parregullt, ta zvogëlojnë varfërinë në familjet që marrin remitenca nga jashtë, dhe të kanalizojnë më shumë migrantë në programe të rregullta që plotësojnë mungesat e fuqisë punëtore në vendet destinacion.²⁶ Kjo sugjeron përfitime dhe përmirësime si për vendin e origjinës, ashtu edhe për vendin e destinacionit, për aq kohë sa njerëzit mund të kenë qasje të vazhdueshme në rrugët ligjore për migracionin legal. Sidoqoftë, ekziston gjithashtu shqetësimi për efektet e ‘ikjes së trurit’ d.m.th. (qytetarëve të kualifikuar) që largohen nga vendi i origjinës. Që në thelb në mënyrë tipike mendohet si negative, studimet kanë treguar disa ndikime pozitive të ikjes së trurit. Për shembull, konstatimet kryesore të Frederic Docquier treguan se, sipas disa hamendësimeve, ‘ikja e trurit’ kontribuon në rritjen e fluksit të remitencave, e stimulon arsimin si dhe i redukton kostot e transaksioneve ndërkombëtare.²⁷

23 Përmbajtja e marrëveshjeve është marrë nga Qendra Informative Gjermane për Migrim, Trajnime dhe Karrierë (DIMAK) në Kosovë.

24 Po aty.

25 Sipas Qendrës Informative Gjermane për Migrim, Trajnime dhe Karrierë (DIMAK) në Kosovë.

26 Kathleen Neeland. Migrimi, Zhvillimi dhe Qeverisja: Nga Kriza Drejt Konsolidimit. Instituti i Politikave të Migracionit, (2019). Burimi: <https://bit.ly/2sZ15Ra>

27 Frédéric Docquier. Ikja e trurit nga vendet në zhvillim. IZA World of Labor (2014). Burimi: <https://bit.ly/37ZOZs4>

Megjithatë, i njëjti studim tregon se efektet negative të ikjes së trurit. Mund të shkaktojnë humbje fiskale dhe të zvogëlojnë kapitalin njerëzor në vendin e origjinës, duke shkaktuar çrregullime nëpër disa profesione.²⁸ Megjithatë, i njëjti studim tregon se efektet negative të ikjes së trurit. Mund të shkaktojnë humbje fiskale dhe të zvogëlojnë kapitalin njerëzor në vendin e origjinës, duke shkaktuar çrregullime nëpër disa profesione.²⁹ Megjithatë, i njëjti studim tregon se efektet negative të ikjes së trurit. Mund të shkaktojnë humbje fiskale dhe të zvogëlojnë kapitalin njerëzor në vendin e origjinës, duke shkaktuar çrregullime nëpër disa profesione.

Në mënyrë të ngjashme, remitencat zakonisht mendohen si të dobishme në vetvete. Sidoqoftë, mund të ketë disa disavantazhe të përealizuara të dërgesave të parave. Sipas studimeve të Departamentit të Politikave në Parlamentin Evropian, në një nivel mikro, remitencat mund të çojnë në “një rritje të presionit mbi dërguesit, një kulturë në rritje të varësisë në vendet në zhvillim që e minon motivimin e pranuesit (marrësit) të parave që të punojë, rritje të shpenzimeve konsumuese të pranuesit si dhe rritje e pabarazive (ndërmjet marrësve dhe jo-marrësve, zonave rurale dhe atyre urbane).”³⁰

Sidoqoftë, kjo është në kundërshtim me përfitimet e tyre pozitive që përmenden në mënyrë të barabartë në po të njëjtin studim, të tilla si rritja e të ardhurave të marrësve dhe aftësi i tyre për të investuar në nevojat të tilla si shëndetësia dhe arsimi.³¹ Në nivelin makro, një model i ngjashëm paraqitet: ndërsa remitencat mund të kontribuojnë në humbje të konkurrencës kombëtare dhe të rrisin korrupsionin, ato gjithashtu kontribuojnë në “rritjen e vlerës së kredisë së një vendi dhe thellimin e tregut financiar lokal.”³² Në këtë kuptim, remitencat sjellin pluse e minuse të konsiderueshëm që duhet të peshohen dhe të merren parasysh gjatë krijimit të politikave.

Nga pikëpamja ekonomike, një skepticizëm i zakonshëm në mesin e shtetasve që marrin emigrantë është se fluksi mund të çojë në më pak mundësi pune dhe ngecje të pagave. Ndërkohë, financat publike dhe bilanci i pagesave mund të preken për shkak të rrjeteve të ndryshme të sigurimeve shoqërore dhe të remitencave. Nga ana tjetër, kur njerëzit emigrojnë, vendi i origjinës ka frikë nga ikja e trurit, shënohet rritje e pagave duke i bërë kompanitë më pak konkurruese, rritja e pagës së rezervimit³³ çon në mos-aktivitet, etj.

Studimet empirike sugjerojnë që rritja e numrit të emigrantëve nuk ka ndikim të vazhdueshëm negativ në paga.³⁴ Në rastin e Gjermanisë, të dhënat tregojnë se përkundër rritjes së vazhdueshme të imigracionit të punës, vendi ka përjetuar një shkallë rekord të ulët të papunësisë dhe shkallën më të lartë të numrit të vendeve të lira të punës që nga viti 2006. Gjatë kësaj kohe, si paga, ashtu edhe PBB reale janë rritur vazhdimisht. Mungesa e fuqisë punëtore e kufizon zgjerimin e ekonomisë, gjë që paraqet kosto të konsiderueshme për bizneset që kërkojnë të rrisin prodhimin dhe të mbeten konkurrues në tregun botëror. Prandaj, ndonëse Gjermania ka krijuar më shumë rrugë ligjore për emigrantët për të hyrë në tregun e saj të punës, ekonomia e saj ka potencialin për të tërhequr një numër edhe më të madh të emigrantëve në zonat ku numri i vendeve të lira të punës mbetet i lartë.

28 Po aty.

29 Po aty.

30 Karine Manyonga Kamuleta LUBAMBU. Efektet e remitencave në vendet në zhvillim. Drejtorja e Përgjithshme për Politika të Jashtme, Departamenti i Politikave (2014). Burimi: <https://bit.ly/2Y1L6O9>

31 Po aty.

32 Po aty.


33 Market Business News e definon pagën rezervë si vijon: “[p]aga rezervë i referohet shumës më të vogël të parave që një person do ta merrte në konsideratë që të punonte në një pozitë ose lloj të punësimit.” Burimi: <https://bit.ly/2v16zks>

34 Anthony Edo et al. Efektet e remitencave në vendet në zhvillim: Konsideratat nga Hulumtimet Ekonomike të Kohëve të Fundit. CEPPI (Centre d’Etudes Prospectives et d’Informations Internationales) (2018). Burimi: <https://bit.ly/2mFbMol>

Deficiti në tregun e punës në Gjermani

Gjermania është ekonomia më e madhe kombëtare e Evropës sa i përket rritjes ekonomike duke vazhduar që nga viti 2010. Gjatë vitit 2018, PBB-ja reale u rrit me 1.5 përqind krahasuar me një vit më parë.³⁵ Rritja e vazhdueshme e aktivitetit ekonomik ka nxitur punësimin. Në 2018, norma e punësimit arriti pikën e saj më të lartë të paktën që nga vitet e 1990-ta³⁶ dhe norma e papunësisë shënoi një rekord të ulët. Figura 1 tregon trendin e papunësisë në Gjermani gjatë viteve të fundit. Në korrik të vitit 2019, kjo normë ra aq ulët sa ra në tre përqind, duke e bërë normën e papunësisë më të ulët në Gjermani që nga vitet 1980-ta.³⁷

Figura 1. Norma e punësimit dhe e papunësisë në vitet e fundit në Gjermani



Burimi: Eurostat³⁸

Përveç efektit pozitiv të normave të ulëta të papunësisë, një rënie nën normën natyrore të papunësisë³⁹ mund të jetë e dëmshme për ekonominë pasi që mund të shkaktojë inflacionin e pagave: kompanitë që konkurrojnë për një sasi të kufizuar të fuqisë punëtore mund të bëjnë që pagat të rriten vazhdimisht. Pagat e larta reflektohen në çmimet e prodhimit, duke i bërë kompanitë gjermane më pak konkurruese me pjesën tjetër të botës.

Në Gjermani, rritjet e vazhdueshme në punësim rriten të ardhurat reale të punonjësve. Sipas indeksit të të ardhurave, paga nominale në vitin 2018 u rrit me 3.1 përqind, ndërsa Zyra Federale e Statistikave vlerësoi se Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) u rrit me 1.3 përqind gjatë po të njëjtës periudhë. Si rezultat i kësaj, fitimet reale në vitin 2018 u rritën me 1.8 përqind. Vija e kaltër në Figurën 2 tregon rritjen pozitive të fitimeve reale ndër vite.


³⁵ Eurostat. Rritja reale e PBB-së në Gjermani. Burimi: <https://bit.ly/39hXDBs>

³⁶ Zyra Federale e Statistikave (Destatis). Punësimi. Burimi: <https://bit.ly/3oVEzFq>

³⁷ Tradingeconomics. Germany. Burimi: <https://bit.ly/ztzPoxu>


³⁸ Eurostat. Norma e gjithmbarshme e papunësisë. Burimi: <https://bit.ly/2TnnrVf>

³⁹ Julia Kagan përcakton normën natyrore të papunësisë si më poshtë "[p]apunësia natyrore pasqyron numrin e njerëzve që janë të papunë për shkak të strukturës së fuqisë punëtore siç janë ata që zëvendësohen nga teknologjia ose ata që nuk kanë shkathtësi të caktuara për të përfituar punësim." Investopedia (2019). Burimi: <https://bit.ly/2VogWh1>

Figura 2. Ndryshimi në përqindje në fitimet reale dhe nominale në Gjermani

Burimi: Zyra Federale e Statistikave (Destatis)⁴⁰

Arsye bindëse për rritjen e vazhdueshme të pagës reale mund të jetë që shumë kompani po konkurrojnë për një fuqi të kufizuar punëtore. Vitet e fundit, lloje të ndryshme të industrive që operojnë në Gjermani kanë shprehur shqetësime në lidhje me mungesën si të fuqisë punëtore⁴¹ të kualifikuar⁴² dhe të asaj të pakualifikuar.⁴³ Në tremujorin e fundit të vitit 2018 dhe tremujorin e parë të vitit 2019, norma e vendeve të lira të punës⁴⁴ u rrit me 3.4 përkatësisht me 3.3 përqind. Kjo shënon nivelin më të lartë që nga viti 2006.

Figura 3. Norma e vendeve të lira të punës në Gjermani për të gjitha profesionet

Burimi: Eurostat⁴⁵

⁴⁰ Zyra Federale e Statistikave (Destatis). Çereku i parë i vitit 2019: të ardhurat reale janë rritur me 1.2%, vit pas viti. Burimi: <https://bit.ly/2LS23Lq>

⁴¹ Tobias Buck. Gjermania i ka sytë kah punëtorët e huaj për të trajtuar mungesën e fuqisë punëtore. Financial Times (2018). Burimi: <https://on.ft.com/2t4kuA3>

⁴² Punëtor i kualifikuar konsiderohet personi i cili ka diplomë universitare ose ata që kanë përfituar certifikatë të trajnimeve profesionale ekuivalente me standardet gjermane.


⁴³ Punëtor me kualifikim të ulët konsiderohet personi i cili nuk ka kualifikime ose trajnime profesionale jo formale, që njihet zyrtarisht në Gjermani. Ndonëse, i punësuar prapëseprapë mund të ketë shkathtësi/afhtësi në praktikë.

⁴⁴ Sipas EUROSTAT-it, statistikatat për vendet e punës "japin informata përkitazi me kërkesën e papërmbyshur për punë." Shkalla e vendeve të lira të punës është përpjesëtimi ndërmjet numrit të gjithmbarshëm të posteve të lira dhe numrit të gjithmbarshëm të posteve (të plotësuar dhe të lira).

⁴⁵ Eurostat. Statistikat mbi vendet e lira të punës sipas NACE Rev. 2 activity – të dhënat për tremujorin. Burimi: <https://bit.ly/2lJND07>

Rritja e aktivitetit ekonomik në Gjermani, e shoqëruar me furnizim të kufizuar me fuqi punëtore i kushton industrisë në mënyrë të konsiderueshme. Sipas Institutit Ekonomik të Gjermanisë (IWF), postet e paplotësuara të punës i kushtojnë ekonomisë së Gjermanisë rreth 30 miliardë euro çdo vit.⁴⁶ Disa industri kanë më shumë vështirësi në plotësimin e posteve sesa të tjerat. Figura 4 tregon vendet e lira të punës sipas profesioneve gjatë vitit 2018. Profesione të tilla si aktivitete të shërbimit administrativ dhe ndihmës, shëndeti i njeriut dhe punën sociale, prodhimi dhe ndërtimi janë ndër profesionet me kërkesë më të lartë në Gjermani.

Figura 4. Mesatarja e numrit të vendeve të lira të punës në Gjermani në 2018 sipas profesioneve



Burimi: Eurostat⁴⁷

46 Kate Connolly. Gjermania miraton ligjin e migracionit për t'i joshur punëtorët jo të kualifikuar nga vendet jo të BE-së. The Guardian (2018). Burimi: <https://bit.ly/2Sakt51>. Kompanitë gjermane humbin biznes në vlerë prej 300 miliardë eurosh nga puna ilegale. Xinhua (2019). Burimi: <https://bit.ly/2lh2Yoy>

47 Statistikat mbi vendet e lira të punës sipas NACE Rev. 2 activity – të dhënat për tremujorin. Eurostat. Burimi: <https://bit.ly/2Rvz3X5>

Përveç profesioneve të lartpërmendura, mungesa e fuqisë punëtore në sektorin e kujdesit shëndetësor ka të ngjarë të bëhet edhe më problematike në të ardhmen e afërt për shkak të plakjes së popullsisë në Gjermani.⁴⁸ Aktualisht, Gjermania ka më shumë banorë mbi moshën 60 vjeç sesa nën 30 vjeç.⁴⁹ Me këtë trend, mbajtja e sistemit aktual të pensioneve dhe të politikave të tjera sociale pa rritur borxhin e vendit do të jetë sfidë. Duke pasur parasysh zotimin e Gjermanisë për të mbajtur një buxhet të ekuilibruar, rritja e borxhit të vendit është e përealizueshme. Përndryshe, do të ketë nevojë për fuqi punëtore shtesë për të ruajtur këtë ekuilibër. Një studim i fundit ka konstatuar se nëse fuqia punëtore potenciale do të mbulonte nevojat e parashikuara të tregut të punës, atëherë mes viteve 2018 dhe 2060 do të ishte i nevojshëm një emigrim vjetor neto i 146,000 migrantëve nga vendet jo të BE-së.⁵⁰

Migrimi për punësim në Gjermani nga vendet e BE-së dhe jo të BE-së

Numri i vendeve të lira të punës mbetet i lartë pavarësisht fluksit të vazhdueshëm të emigrantëve në Gjermani. Në vitin 2018, imigrimi në Gjermani ishte 1.585,000 ndërsa emigrimi ishte 1.185,000 me një imigrim neto prej 400,000.⁵¹ Nga imigrimi i përgjithshëm çdo vit, Gjermania tërheq më shumë njerëz nga vendet e BE-së sesa shtetas jo të BE-së. Përfshirje nga ky trend kanë ndodhur në vitet 2015 dhe 2016 për shkak të fluksit masiv të azilkërkuësve.

Nga numri i përgjithshëm i emigrantëve të BE-së që vijnë në Gjermani për qëllime punësimi përmes mobilitetit të brendshëm të BE-së, shumica janë punëtorë të kualifikuar. Sipas Zyrës Federale të Statistikave (Destatis), në vitin 2017, 61 përqind e emigrantëve të Gjermanisë në BE kishin kualifikime profesionale.⁵²

Ndërsa qytetarët nga Zona Ekonomike Evropiane⁵³ përjashtohen nga kërkesa për një titull qëndrimi për shkak të lëvizjes së lirë të regjimit të personave,⁵⁴ shtetasve jo të BE-së u kërkohet të kenë një leje në formën e vizës në mënyrë që të hyjnë dhe të qëndrojnë në Gjermani. Titujt kryesorë të qëndrimit janë vizat, lejet e qëndrimit, lejet e banimit, lejet e qëndrimit afatgjatë të BE-së dhe Kartat Blu të BE-së.⁵⁵ Kur emigrimi për qëllime punësimi, Gjermania ka Aktin (Ligjin) e Vendbanimit (Aufenthaltsgesetz or AufenthG),⁵⁶ veçanërisht Nenet 18, 19 dhe 20, që e rregullojnë migracionin e punës (shiko Shtojcën 1). Për të marrë një leje qëndrimi për punësim, Agjencia Federale e Punësimit duhet të japë aprovimin e saj. Për disa kategori të veçanta, punësimi ose trajnimi lejohet përmes marrëveshjeve ndërqeveritare të vendosjes.

48 Antje Schwinger et al. Pflegepersonal heute und morgen. In: Jacobs et al. Pflege-Report 2019. Mehr Personal in der Langzeitpflege – aber woher? Berlin: Springer (2020). Burimi: <https://bit.ly/zuEj8fP>

49 Jeff Desjardins. Germany will hit a significant demographic milestone over the next year. World Economic Forum (2018). Burimi: <https://bit.ly/2ElXnjQ>

50 Johann Fuchs et al. Zuwanderung und Digitalisierung: Wie viel Migration aus Drittstaaten benötigt der deutsche Arbeitsmarkt künftig? Bertelsmann Stiftung, Gütersloh (2019). Burimi: <https://bit.ly/3aJdObK>

51 Agjencia Federale e Statistikave (Destatis). Migrimi. Burimi: <https://bit.ly/2NZtgel>

52 Matthias M. Mayer. Skilled worker migration to Germany from third countries 2017. Bertelsmann Stiftung, Gütersloh (2018). Burimi: <https://bit.ly/2Fjy4SQ>


53 ZEE-ja përfshin të gjitha shtetet anëtare të BE-së plus Islandën, Lihtenshtajnin dhe Norvegjinë.

54 Neni 2, E drejta e hyrjes dhe e banimit të Ligjit për Lirinë e Përgjithshme të Lëvizjes për shtetasit e BE-së (FreizügG/EU). Burimi: <https://bit.ly/38GncWZ>

55 Janne Grote and Michael Vollmer. Opportunities to change the [sic] residence title and the purpose of stay in Germany. German National Contact Point for the European Migration Network (EMN) (2016). Burimi: <https://bit.ly/2lyygvk>

56 Akti (Ligji) për Qëndrimin (AufenthG). Burimi: <https://bit.ly/2lSQrba>

Figura 5. Emigrantët e kualifikuar ose me kualifikim të ulët të punës nga vendet e treta për në Gjermani me ofertë punë të sigurt, sipas llojit të lejes së qëndrimit (2012-2018)



Burimi: Zyra Federal për Migracion dhe Refugjatë – BAMF⁵⁷

Figura 5 tregon se në vitin 2018, nga 60,857 emigrantë të punës nga vendet jo të BE-së, 64 përqind ishin punëtorë të kualifikuar. Migrimi i përgjithshëm dhe numri i punëtorëve të kualifikuar janë rritur me kalimin e viteve. Ndonëse, pjesa e personave të kualifikuar në krahasim me punëtorët e pakualifikuar është zvogëluar në tre vitet e fundit, leja e qëndrimit më e njohur për punëtorët e kualifikuar vazhdon të jetë Karta Blu e BE-së.

Karta Blu e BE-së përfshin si lejen qëndrimi, ashtu edhe autorizimin për punë për shtetasit jo të BE-së ose jo të Zonës Ekonomike Evropiane. Po ashtu, është një dokument i nevojshëm për të fituar më vonë qëndrim të përhershëm dhe shtetësi të BE-së. Sipas Zyrës Federale të Gjermanisë për Migracionin dhe Refugjatët (BAMF), që nga miratimi i Kartës Blu të BE-së në vitin 2012, Gjermania mbetet destinacioni kryesor i migrantëve me kualifikim të lartë krahasuar me vendet e tjera të BE-së, me 85 përqind të numrit të përgjithshëm të lëshimit të këtyre kartave që vijnë nga Gjermania.⁵⁸ Në vitin 2018, Gjermania ka lëshuar 25 përqind më shumë Karta Blu të BE-së sesa në vitin 2017.⁵⁹

⁵⁷ Hans-Eckhard Sommer, Broshura "Zyra Federale në numra. Zyra Federale për Migrim dhe Refugjatë – BAMF, 2018" (2019). Burimi: <https://bit.ly/2Rv43Xi>

⁵⁸ Germany-visa.org. Numri i mbajtësve të 'Kartave Blu' në Gjermani rritet shumë për [sic] 25% në vitin 2018 (2019). Burimi: <https://bit.ly/3ojUr3B>

⁵⁹ Po aty.

Nxitja e migrimit për punë (të punëtorëve të kualifikuar dhe pakualifikuar) nga Ballkani Perëndimor

Megjithëse numri i punëtorëve të kualifikuar e tejkalon numrin e punëtorëve të pakualifikuar, pjesa e punëtorëve të pakualifikuar është rritur me kalimin e viteve. Nga viti 2015 deri në vitin 2016, numri i fuqisë punëtore të pakualifikuar është rritur me gati 70 përqind, por që prej atëherë ky numër ka mbetur stabil.

Një arsye për rritjen e shpejtë të migracionit të punës në vitin 2016 mund të jetë prezantimi i RRBP-së në vitin 2015, ku nuk specifikohet ndonjë kusht sa i përket kualifikimit, duke lejuar punëtorë të kualifikuar dhe të pakualifikuar të hyjnë në tregun gjerman të punës.

Në periudhën tre-vjeçare (2016 deri në 2018), numri tronditës prej 204,638 kontratave të punës të paraqitura nga shtetas të vendeve të BP-së ishin subjekt i shqyrtimit nga AFP, rreth 80 përqind (163,241) e të cilave ishin para-aprovuar.⁶⁰ Sidoqoftë, vetëm 40 përqind e rasteve të para-aprovuara i kaluan të gjitha kriteret për të marrë një vizë pune.⁶¹ Tabela 1 tregon gjithashtu se Kosova kishte numrin më të madh të të dyja llojeve të aplikimeve dhe aprovimeve të vizave sipas Nenit 26.2, ndonëse ka popullsinë e dytë më të vogël në Ballkanin Perëndimor: një e treta e të gjitha aplikacioneve vinin nga Kosova, dhe rreth 24 përqind e të gjithë vizave të punës ishin lëshuar për qytetarët e Kosovës.

Tabela 1. Numri i para-aprovimeve të lëshuara dhe të refuzuara dhe i vizave sipas nenit 26.2

	Viti	Totali	 SHQ	 BeH	 KOS	 MQV	 MNE	 SRB
Kontratat e punës Të dorëzuara në Agjencinë e Punësimit Për Shqyrtim sipas §26.2	2016	53,583	3,933	13,889	18,182	6,213	1,313	10,050
	2017	94,280	8,235	21,206	36,245	11,452	1,839	15,301
	2018	56,775	9,376	11,398	12,845	12,683	1,978	8,495
Para-aprovimet e miratuara	2016	42,546	2,977	11,330	14,419	4,746	1,012	8,059
	2017	74,577	6,053	17,220	28,816	8,918	1,433	12,135
	2018	46,118	7,052	9,684	10,693	10,059	1,476	7,154
Para-aprovimet e refuzuara	2016	11,037	956	2,559	3,763	1,467	301	1,991
	2017	19,703	2,182	3,986	7,429	2,534	406	3,166
	2018	10,657	2,324	1,714	2,152	2,624	502	1,341
Vizat e lëshuara sipas §26.2	2016	18,752	1,228	5,581	5,102	2,635	678	3,528
	2017	25,341	2,796	5,933	6,012	5,167	856	4,577
	2018	21,078	4,254	2,612	4,710	5,360	971	3,171

Burimi: Agjencia Federale e Punësimit⁶² dhe Zyra Federale për të Huajt⁶³

60 Për procedurat që kanë të bëjnë me lëshimin e para-aprovimeve nga AFP referoju Rubrikës 1.

61 Përkitazi me procedurën e Agjencisë Federale të Punësimit për aprovimin ose refuzimin e vizave referoju Rubrikës 1.

62 Bundesagentur für Arbeit. Consents u. Refuzimi për të punuar ndaj shtetasve të vendeve të treta - Gjermani, drejtoritë e landeve dhe regjionale (seria sipas vitit dhe kohës) - Dhjetor 2018. Burimi: <https://bit.ly/2nlkrwE>.

63 Andreas Michaelis. Vizat e punës për Ballkanin Perëndimor në vitin 2018. Zyra Federale të Huajt (2019). Burimi: <https://bit.ly/2niZDpx>

Në vitin 2015, para prezantimit të RRBp-së, Gjermania i shpalli Kosovën, Shqipërinë dhe Malin e Zi vendet e sigurta të origjinës, duke u bashkuar me tre vendet e tjera të BP-së (Serbia, BeH dhe Maqedonia e Veriut) që e kishin marrë këtë status më parë. Kjo masë, e shoqëruar me fushata të gjera mediatike lidhur me statusin e ri të vendeve të BP-së, rezultoi në kërkesa më të ulëta për azil. Numri i azilkërkuesve ra me 72 përqind, nga 120.882 në 2015 në 34.360 në 2016.⁶⁴

Shumica e aprovimeve të miratuara nga AFP për aplikantët nga vendet e BP-së ishin për punë në lëmin e ndërtimit. Kategoritë e ardhshme që morën një numër të madh aprovimesh ishin industria e akomodimit dhe shërbimet ushqimore, si dhe sektorët e shëndetit të njeriut dhe ajo e punës sociale. Të njëjtat profesione gjithashtu kishin numrin më të madh të aplikacioneve të refuzuara (shih Shtojcën 2).

Ndonëse këto politika liberale të pranimit rrisnin emigracionin për punë në Gjermani, RRBp-ja kritikohet për kohën e ngadaltë të përpunimit dhe tendencën për t'u keqpërdorur përmes kontratave mashtruese të punës. Pas marrjes së kontratave të punës, të dyja palët, punëdhënësit në Gjermani dhe punonjësit nga vendet jo të BE-së duhej të prisnin periudha të gjata kohore derisa të aprovohej vizat e punës (shiko Rubrikën 1 për procedurën e aprovimit). Sipas ambasadës gjermane në Prishtinë, periudha e pritjes për aplikime për viza përmes nenit 26.2 të Urdhërësës së Punësimit pritet të jetë më shumë se një vit.⁶⁵ Shumë punëdhënës nuk mund të presin kaq gjatë për të plotësuar një post të hapur. Për më tepër, shumë aplikime sipas RRBp-së, që ishin refuzuar nga Agjencia Federale e Punësimit, përbënin kontrata mashtruese të punës, ku një kompani e vogël lëshonte më shumë kontrata pune sesa kapaciteti i saj i punësimit.⁶⁶ Një aspekt tjetër i RRBp-së që e galvanizoi debatin në vendet e target të BP-së është fakti se kjo politikë ishte hartuar dhe miratuar në mënyrë të njëanshme. Gjersa kjo politikë po diskutohet dhe analizohet në Gjermani në lidhje me implikimet në administrimin e migracionit të parregullt dhe kërkesës për fuqi punëtore, kishte shumë pak ose aspak komunikime në lidhje me këtë rregullore në vendet e BP-së, dhe as se si do të ndikonte kjo politikë në to.

Shqetësimet e vendeve të BP-së pritet të rriten me zbatimin e një rregulloreje të re në mars të vitit 2020. Me gjithë rritjen e migracionit të kualifikuar dhe të pakualifikuar në Gjermani përmes rregulloreve të ndryshme, që nga viti 2019, mungesat sa i përket fuqisë punëtore mbetën të dukshme, gjë që ka nxitur një dialog të ri midis publikut, qarqeve politike dhe akademike në lidhje me ndryshimet shtesë në ligjet aktuale të migracionit për të lejuar që punëdhënësit të rekrutojnë punëtorë të kualifikuar më lehtë dhe më shpejtë. Si rezultat i kësaj, Gjermania paraqiti ligjin e saj më liberal për imigracionin deri më sot: Fachkräfteeinwanderungsgesetz - FKEG (Akti për Imigracionin e Kualifikuar), që u miratua më 7 qershor 2019.⁶⁷

64 Bither dhe Ziebarth. Krijimi i rrugëve ligjore për reduktimin e migrimit të parregullt? Çfarë mund të mësojmë nga "Rregullorja për Ballkanin Perëndimor" e Gjermanisë. Fondi Marshall për Gjermaninë e Shteteve të Bashkuara. (2018). Burimi: <https://bit.ly/2MjzQAb>

65 Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë. Pyetjet që shtrohen më së shpeshti. Sa gjatë duhet të pritët për një termin? (2018). Burimi: <https://bit.ly/2liNQa4>

66 Krijimi i rrugëve ligjore për reduktimin e migrimit të parregullt? Çfarë mund të mësojmë nga "Rregullorja për Ballkanin Perëndimor" e Gjermanisë." Burimi: <https://bit.ly/37elBKT>

67 Gazeta Federale e Ligjeve. Ligji për Migracionin e Kualifikuar (2019). Burimi: <https://bit.ly/3oZo6jm>

Akti për Imigracionin e Kualifikuar, që do të hyjë në fuqi në mars të vitit 2020 do të përfshijë ndryshimet e mëposhtme kryesore në Aktin (Ligjin) e Qëndrimit:

- Punëdhënësit nuk do t'u nënshtrohen kufizimeve të mëparshme në sektorët e punës ku ka mungesa të fuqisë punëtore kur punësojnë punëtorë me arsim profesional.
- Profesionistët me përvojë të TI-së do të kenë të drejtë për leje pune, edhe pa një diplomë zyrtare arsimore ekuivalente me standardet gjermane, ndërsa për të gjitha profesionet e tjera, ky parakusht mbetet në fuqi; megjithatë, një titull (leje) qëndrimi mund të jepet për azhurnimin e programeve.
- Punëdhënësve nuk do t'ju kërkohet të dëshmojnë se ka banorë të tjerë gjermanë ose kandidatë të privilegjuar të kualifikuar për atë post (heqja e kontrollit të prioritetit).
- Punëtorët e kualifikuar me aftësim profesional do t'i kenë të njëjtat të drejta si punëtorët me kualifikime të larta kur aplikojnë për statusin e emigrantit.
- Një vizë me qëllim të kërkimit të një pune të duhur për punëtorë të kualifikuar ose një pozitë e aftësimit profesional për të rriturit jepet nëse plotësohen disa kushte të tjera (p.sh. aftësia për t'i mbuluar shpenzimet e jetesës dhe që të mos ketë të kaluar kriminale).
- Pas katër vitesh punë, profesionistët e kualifikuar do të kenë mundësinë të bëhen banorë të përhershëm.

Ligji i ri i imigracionit pritet që ta përshpejtojë ndjeshëm procesin e marrjes së lejes së punës. Për më tepër, qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor, ashtu si edhe shtetasit e tjerë të vendeve të treta, kanë mundësi të marrin vizë për të shkuar në Gjermani për gjashtë muaj për të kërkuar një vend pune, me kusht që ata të kenë një diplomë akademike ose një certifikatë të njohur të aftësimit profesional plus kapital të mjaftueshëm për ta mbajtur veten gjatë kësaj periudhe. Nëse gjejnë një vend pune, ata mund të marrin leje pune dhe leje qëndrimi pothuajse menjëherë.

Sidoqoftë, shtetasit e Kosovës që synojnë të punojnë në Gjermani pa i përmbushur këto parakushte ende janë në disavantazh në mesin e vendeve të BP-së, pasi që kërkesa për vizë për qëndrime afatshkurtra në zonën Schengen mbetet. Avantazhi i regjimit pa viza është se çdo migrant potencial i punës mund të udhëtojë në "modalitetin turistik" për tre muaj në mënyrë që të sigurojë një vend pune në përputhje me Ligjin e Migracionit të Kualifikuar ose, në rast se ai ose ajo është pa kualifikime të verifikuara, sipas i nenit 26.2 të Urdhëresës së Punësimit.

Sfondi sfidues i tregut të punës në Kosovë

Demografia aktuale dhe e parashikuar janë përbërës të rëndësishëm për vlerësimin e potencialit të tregut të punës. Tabela 2 tregon se deri në vitin 2051, shkalla e shtimit të popullsisë së Kosovës pritet të rritet. E lidhur me këtë, pritet të rritet numri i popullsisë në moshë pune; megjithatë, një rënie e madhe e rritjes parashikohet të ndodhë në fazën e dytë të këtij parashikimi. Rënia ka të ngjarë të rezultojë me një ndryshim të madh strukturor në popullatë, ku rinia do të hyjë në moshën madhore dhe grupi i madh i të rriturve aktualë do të bartet në grupin e të moshuarve. Sidoqoftë, duke supozuar se përqindja e punësimit të synuar të BE-së është 75 përqind, Kosova pritet të ketë rreth gjysmë milioni njerëz të moshës së punës të papunë deri në vitin 2021.

Tabela 2. Vlerësimet për numrin e popullsisë 2011-2051, sipas aktivitetit ekonomik dhe gjinisë

Treguesit demografik dhe të tregut të punës	2011	2021	2031	2041	2051	% ndryshim 2011-2021	% ndryshim 2021-2031
Popullsia gjithsej	1,780,021	1,883,805	1,931,957	1,923,157	1,859,447	5.8%	2.6%
Burra	896,426	952,170	979,886	975,977	943,659	6.2%	2.9%
Gra	883,595	931,635	952,071	947,198	915,788	5.4%	2.2%
6 vjeç	31,604	25,544	24,532	20,120	16,457	-19.2%	-4.0%
15 vjeç	35,313	29,985	24,413	23,263	18,838.0	-15.1%	-18.6%
18 vjeç	36,159	33,389	24,664	23,868	20,141	-7.7%	-26.1%
Mosha e punës 15-64	1,162,044	1,301,556	1,308,552	1,262,015	1,177,814	12.0%	0.5%
Popullsi aktive	533,698	602,190	609,595	591,499	552,502	12.8%	1.2%
Totali i punësimit	378,808	427,997	412,007	392,206	393,276	13.0%	-3.7%
Niveli i synuar i punësimit (Norma e synuar e punësimit në BE 75%)	871,533	976,167	981,401	946,511	883,361	12.0%	0.5%
Hendeku ndërmjet synimit dhe vlerësimeve të përafërta	492,725	548,170	569,394	554,305	490,085	11.3%	3.9%

Burimi: Projektioni i popullatës së Kosovës 2011-2061, ASK, bazuar në ALLED (2015), Vlerësimi i Nevojave të Tregut të Punës dhe Analiza e Nevojave të Tregut të Punës në Kosovë⁶⁸

Sipas Bankës Botërore, që nga viti 2018, Kosova ka një PBB për kokë banori prej 4,302 dollarësh.⁶⁹ Në krahasim me vendet e tjera në Evropë, Kosova është vendi i katërt më i varfër pas Moldavisë, Ukrainës dhe Armenisë. Në vitin 2018, shkalla e papunësisë ishte 29.6 përqind dhe papunësia e të rinjve (15-24 vjeç) arriti deri në 55.4 përqind, në një vend ku mosha mesatare është 29.6.⁷⁰ Sipas një studimi të Gallup, aspirata e një individi për të migruar lidhet fort me moshën e tyre. Në mënyrë të veçantë, të rinjtë e moshës 15 deri në 24 vjeç kanë shumë më shumë gjasa të migrojnë sesa grupmoshat tjera.⁷¹ Një përfundim i ngjashëm u nxor në një studim me qytetarët e Kosovës sa i përket moshës së migrantëve potencialë.⁷²


68 Avni Kastrati dhe të tjerët. Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061. Agjencia e Statistikave të Kosovës (2017). Burimi: <https://bit.ly/2s1VfOE>. Besnik Krasniqi. Analiza e nevojave të tregut të punës dhe e aftësive në Kosovë: Perspektiva për të ardhmen. Research Gate (2019). Burimi: <https://bit.ly/2Fzc7Q1>

69 Banka Botërore. PBB-ja për kokë banori (valuta në US dollar). Burimi: <https://bit.ly/3b6atnu>

70 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2018 (2019). Burimi: <https://bit.ly/36qZan3>

71 Julie Ray dhe Neli Esipova. Migrantët potencial në botë shpesh janë të rinj, të arsimuar, dhe në gjendje të mirë. Anketa e Gallup (2011). Burimi: <https://bit.ly/2moHQwl>

72 Grupi për Studime Juridike dhe Politike. Profili i migrantëve potencialë që kanë më së shumti dëshirë për të migruar? (2015). Burimi: <https://bit.ly/2SedUji>

Figura 6. Norma e punësimit dhe e papunësisë në Kosovë kohëve të fundit

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës –Anketa e fuqisë punëtore në Kosovë⁷³

Mungesa e perspektivës së punësimit së bashku me faktorë të tjerë mund të ketë shkaktuar pasivitet të lartë ndër vite. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) që nga viti 2018, 60 përqind e popullsisë në moshë pune ka qenë joaktive, 80 përqind e të cilave ishin gra.⁷⁴ Ky nivel i përdorimit të pamjaftueshëm të burimeve të fuqisë punëtore paraqet kosto të konsiderueshme për një ekonomi në zhvillim siç është Kosova. Në vitin 2019, më shumë se 80 përqind e punëtorëve me orar jo të plotë në Kosovë deklaruan se arsyeja e punës së tyre me orar jo të plotë ishte mungesa e vendeve të punës me orar të plotë.⁷⁵

Përveç pasojave ekonomike, papunësia afatgjatë krijon kosto personale dhe shoqërore. Në nivelin individual, të qenit i papunë për një periudhë të gjatë kohore mund të shkaktojë humbje të aftësive, mungesë të pavarësisë ekonomike dhe depresion.⁷⁶ Papunësia e lartë mund të nxjerr në pah probleme shoqërore siç janë diskriminimi, shkelja e të drejtave të punës, etj.. Përfaqësuesit e Sindikatës së Punës të Sektorit Privat në Kosovë deklaruan se 50 përqind e të punësuarve punojnë pa kontratë, ndërsa ASK-ja vlerëson se ky numër është rreth 20 përqind.⁷⁷ Në mënyrë të ngjashme, Raporti për (Vendin) Kosovën gjithashtu vuri në dukje mungesën e zbatimit të Ligjit të Punës të Kosovës dhe rritjen e numrit të vdekjeve që lidhen me punën në vitin 2018 për shkak të kushteve të pasigurta të punës.⁷⁸ Me shkallën e lartë aktuale të papunësisë, punonjësit mund të jenë ngurrues sa i përket negocimit të kushteve të punës me punëdhënësit e tyre.

73 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2018 (2019). Burimi: <https://bit.ly/2lfOZd> Index Mundi. Kosovo Demographics Profile 2019 (2019). Burimi: <https://bit.ly/2QOoRXZ>


74 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2018

75 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë Q2 2019 (2019). Burimi: <https://bit.ly/2m3Qlo4>

76 Kimberly Amadeo. Papunësia afatgjatë, shkakton dhe efektet e saj. Bilanci - (2020). Burimi: <https://bit.ly/2MALuxS>


77 Koha Ditore. 2018, viti me më së shumti raste të vdekjeve në vendin e punës (2018). Burimi: <https://bit.ly/2kuPHZd> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë 2018

78 Komisioni Evropian. Raporti i Progresit për Kosovën 2019 (2019). Burimi: <https://bit.ly/2KckkwX>

Figura 7. Ndryshimet në përqindje në të hyrat reale dhe nominale të Kosovës

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Niveli i pagave dhe Indeksi i Çmimeve të Konsumit⁷⁹

Paga mesatare mujore në sektorin publik është 510 euro në muaj, ndërsa në sektorin privat është 365 euro.⁸⁰ Figura 7 tregon se pagat reale janë rritur kohët e fundit, megjithatë, nxitësi kryesor i kësaj rritje ka qenë sektori publik. Rritja e madhe në vitin 2014 është për shkak të vendimit të qeverisë për të rritur pagat e sektorit publik me 25 përqind.⁸¹ Të ardhurat reale në sektorin privat kanë qenë modeste me rritje mesatare prej 0.8 përqind gjatë gjashtë viteve të fundit.⁸²

Figura 8. 2018 papunësia sipas nivelit arsimor, bazuar në metodologjinë e klasifikimit ISCED 2011

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës – Papunësia bazuar në nivelin arsimor⁸³

Përveç grup-moshës, gjetjet e Gallup sugjerojnë se arsimi është gjithashtu një faktor mbizotërues në mesin e njerëzve që aspirojnë të migrojnë. Sa më i lartë që është arsimimi i një personi, aq më shumë ka të ngjarë që ata të migrojnë.⁸⁴ Në mesin e atyre që ishin të papunë në vitin 2018, 16 përqind (23.200) kishin diploma të arsimit të lartë, ndërsa 39 përqind (57.100) kishin grada pas-sekondare ose jo-terciare.

⁷⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Niveli i pagave dhe indeksi i çmimeve të konsumit. Burimi: <https://bit.ly/2lVZFmS>

⁸⁰ Po aty.

⁸¹ Komuna e Vushtrrisë. Raporti Financiar Vjetor 2014 – Vendimi i Qeverisë nr. 01/176 (2014). Burimi: <https://bit.ly/37DsmqY>

⁸² Agjencia e Statistikave të Kosovës. Niveli i pagave në Kosovë 2012-2017, Anketa e Fuqisë Punëtore (2018). <https://bit.ly/2mr4eWn>


⁸³ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Papunësia sipas nivelit arsimor. Burimi: <https://bit.ly/2mUooGM>

⁸⁴ Ray dhe Espova. Migrantët Potencialë në Botë

Teprica e fuqisë punëtore për sektorë në Kosovë

Në raportin e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit për 2018, “Raporti i Studimit të Fuqisë Punëtore të Kosovës dhe Studimi i Përdorimit të Kohës”, individë të papunë raportuan për profesionin e tyre më të fundit. Figura 9 tregon se bujqësia dhe pylltaria ishin profesionet e grupeve më të mëdha të të papunëve në Kosovë, që pasoheshin nga shitja me shumicë dhe pakicë, aktivitete të tjera të shërbimit dhe punëtorët e ndërtimit. Katër profesionet e para përbënin gjithsej 76.5 përqind të të gjithë të papunëve në 2017-ën.

Figura 9. Norma e papunësisë në Kosovë sipas profesionit në vitin 2017



Burimi: Korporata e Sfidave të Mileniumit – Fuqia Punëtore e Kosovës dhe Raporti Hulumtues Studimor mbi Shfrytëzimin e Kohës⁸⁵

Përveç profesioneve të lartcekura, sektori i kujdesit shëndetësor ka më shumë punëtorë sesa mund të akomodojë. Kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë të Kosovës (FSSHK) në një intervistë me Institutin GAP deklaroi se çdo vit, rreth 350 studentë infermierë diplomojnë nga sistemi arsimor publik dhe 4,000 nga sistemi privat. Në vitin 2018, më pak se 400 sish ishin të punësuar.⁸⁶ Gjatë të njëjtit vit, 1.400 prej këtyre studentëve garuan për 100 poste të lira infermierie. Në një studim të realizuar nga FSSHK-ja në vitin 2014, 60.6 përqind e infermierëve të anketuar u përgjigjën se ata ishin të prirë të emigrojnë, arsyet kryesore janë paga më e lartë (29 përqind) dhe zhvillimi profesional (27 përqind).⁸⁷ Sipas kryetarit, Kosova duhet të ndajë më shumë fonde për të krijuar më shumë pozita në kujdesin shëndetësor. Sidoqoftë, edhe me këto veprime, do të ketë akoma një tepricë të studentëve të papunë pas diplomimit.

Nga ana tjetër, karriera në industrinë e shëndetësisë, më saktësisht kujdesi për të moshuarit, janë ndër profesionet që tregojnë rritjen më të fortë të kërkesës në

⁸⁵ Hira Siddiqui et al. Fuqia Punëtore e Kosovës dhe Raporti Hulumtues Studimor mbi Shfrytëzimin e Kohës. Korporata e Sfidave të Mileniumit (2018). Burimi: <https://bit.ly/2YSqx8U>

⁸⁶ Blerim Sylja, kryetar i Federatës së Sindikatës së Shëndetësisë të Kosovës (FSSHK). Intervista me Institutin GAP, 09.09.2019.

⁸⁷ Po aty.

Gjermani. Sipas Institutit për Kërkime të Punësimit (IAB), duke marrë parasysh trendet aktuale sociale dhe ekonomike, kërkesa për punësim në kujdesin shëndetësor do të vazhdojë të rritet në të ardhmen.⁸⁸ Në korrik të vitit 2019, Ministri Federal Gjerman i Shëndetësisë, Jens Spahn, vizitoi Kosovën ku njoftoi se Gjermanisë i duhen 70,000 infermierë.⁸⁹

Kryetari i FSSHK-së shprehu shqetësimin se ata që fillimisht ishin rekrutuar për punë infermierie nga Kosova nuk u janë caktuar poste tipike infermierie. Përkundrazi, ata rekrutë ofrojnë kujdes për të moshuarit dhe detyra të tjera të ngjashme. Ata punojnë në profesione që i nën-shfrytëzojnë aftësitë e tyre. Ky fenomen, sipas kryetarit, ndodh pjesërisht sepse ato pozita nuk plotësohen lehtësisht në Gjermani, dhe pjesërisht sepse shumica e kualifikimeve që jepen në Kosovë nuk njihen në Gjermani. Në të vërtetë, mungesa e punës në lëmin e kujdesit dhe të infermierisë u referohet punëtorëve të kualifikuar në kuptimin që gradat e tyre konsiderohen ekuivalente me standardet gjermane. Kështu që, në vitin 2017 kishte 522 të papunë të regjistruar për 100 oferta pune për ndihmës të kujdesit për të moshuar (të pakualifikuar ose gjysmë të kualifikuar), ndërsa raporti për kujdestarët për të moshuar (plotësisht të kualifikuar ose të specializuar) ishte 29 të papunë për 100 vende të lira (shiko Dokumentin e Shtypur të Bundestagut Gjerman 19/2455, f. 2).⁹⁰ Kjo vë çështjen e ngritjen e aftësive për përmirësimin dhe zbatimin e masave të vazhdueshme të trajnimit për përshtatjen e aftësive profesionale që janë lart në agjendën e Gjermanisë si vend pritës i fuqisë punëtore.

Me gjithë marrëdhëniet potenciale përplotësuese në sektorin e kujdesit shëndetësor, sektorët e tjerë në Kosovë mund të pësojnë mungesa të fuqisë punëtore për shkak të emigracionit. Përveç shkallës së lartë të papunësisë në Kosovë, bizneset shprehin mungesën e kapaciteteve të fuqisë punëtore si sfidën e tyre kryesore në të bërit biznes. Gjetjet e anketës së Odës Ekonomike të Kosovës me bizneset tregojnë se mbi 80 përqind e ndërmarrjeve po përballen drejtpërdrejt me problemin e fuqisë punëtore të pakualifikuar.⁹¹ Bizneset pretendojnë se ekziston furnizim i mjaftueshëm me punëtorë, por ata nuk janë të kualifikuar profesionalisht për detyrën.

Bizneset pretendojnë se ekziston furnizim i mjaftueshëm me punëtorë, por ata nuk janë të kualifikuar profesionalisht për detyrën.⁹² Në total, më shumë se 85 përqind e punësimit në Kosovë është në sektorin e shërbimeve.⁹³ Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (TIK) dhe shërbimet financiare janë ndër shumë fusha që kanë shtim në eksporte gjatë viteve të fundit.

Një diagnozë mbizotëruese e problemit të tregut të punës në Kosovë është se ka mospërputhje shkathtësisht. Shpesh argumentohet se institucionet arsimore në Kosovë nuk u kanë shërbyer nevojave të ekonomisë. Përkundrazi, ato kanë prodhuar më shumë të diplomuar në sektorë ku ka kërkesë të ulët në Kosovë dhe më pak profesionistë në sektorët ku ka kërkesë më të madhe. Kjo ka çuar deri te një situatë kur të diplomuarit nuk kanë qenë në gjendje t'i shfrytëzojnë arsimimin dhe shkathtësitë e tyre në vendin e punës me gjithë kualifikimet e tyre profesionale sepse ishin orientuar kah fushat e ndryshme. Ky fenomen njihet edhe si 'ikja e trurit'!⁹⁴ Duket se "ikja e trurit" ishte gjithashtu evidente në emigracionin e punës për në Gjermani.

88 Michaela Fuchs and Birgit Fritzsche. Die Gesundheitswirtschaft in Sachsen-Anhalt: Eine Betrachtung des Arbeitsmarktes. Institut für Hultime mbi Punësimin (IAB) (2019). Burimi: <https://bit.ly/2ktUSIK>

89 Koha.net. Zyrtarizohet marrëveshja që çon më shumë infermierë të Kosovës në Gjermani (2019). Burimi: <https://bit.ly/2mmB4a5>

90 Antje Schwinger, Jürgen Klauber, and Chrysanthi Tsiassioti Pflegepersonal heute und morgen. In: Jacobs et al: Pflege-Report 2019. Mehr Personal in der Langzeitpflege – aber woher? Berlin: Springer (2020), pp. 3–21. Burimi: <https://bit.ly/2uEj8fP>

91 Oda Ekonomike e Kosovës. Mungesa e fuqisë së kualifikuar punëtore – sfida për bizneset (2017). Burimi: <https://bit.ly/2kEvlgc>

92 Agjencia e Statistikave të Kosovës. Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP) për Kosovën 2008–2018 (2019). Burimi: <https://bit.ly/2ZC7hKT>

93 Po aty.


94 Komisioni Evropian, EU Migration and Home Affairs. Ikja e trurit. Burimi: <https://bit.ly/3oWzIDW>

Kështu që, për shkak të sistemit të dobët arsimor që nuk reflekton për nevojat e tregut, Kosova ka një deficit dhe një tepëri të punës varësisht nga industria. Shkalla e lartë e papunësisë në Kosovë së bashku me perspektivën e rritjes së emigracionit paraqesin kërcënim për sektorë të caktuar dhe mundësi për të tjerët. Në pjesën tjetër do të analizohet potenciali i një marrëdhënie përplotësuese ndërmjet dy tregjeve të punës – Gjermanisë dhe Kosovës – sipas sektorit.

Fuqia punëtore e Kosovës me sytë kah tregu gjerman për mundësi punësimi

Kosova ka një traditë të gjatë të migrimit në Gjermani, si për arsye politike, ashtu edhe për ato ekonomike. Ndonëse ka pasur një sasi të konsiderueshme të “punëtorëve mysafir” dhe të migracionit familjar që lidhet me ish-Jugosllavinë, veçanërisht në vitet 1970 dhe 1980, migracioni i refugjatëve u bë motivi dominues në fund të viteve 1990-ta dhe në fillim të viteve 2000-ta. Vitet e fundit, migracioni për punë u bë arsye edhe më e rëndësishme: numri i aprovimeve nga Agjencia Federale e Punësimit për të fituar një vend punë në Gjermani bazohet në ofertën për pune është rritur në mënyrë të konsiderueshme që nga viti 2013.

Figura 10. Numri vjetor i para-aprovimeve nga Agjencia Federale e Punësimit për migrantët kosovarë të punës



Burimi: Agjencia Federale e Punësimit

Sipas Bankës Botërore që nga viti 2013, rreth 700,000 kosovarë kanë jetuar në diasporë.⁹⁵ Ndër vendet në të cilat jeton diaspora, Gjermania është një nga vendet më të njohura. Të dhënat e regjistrimit të vitit 2017 nga Zyra Federale e Statistikave të Gjermanisë, Destatis, tregojnë se rreth 433,000 kosovarë jetojnë në Gjermani,⁹⁶ prej të cilëve rreth 66 përqind raportohet se janë të punësuar.⁹⁷ Për shkak të kësaj pritshmërie për punësim dhe cilësisë së lartë të jetës, Gjermania pranon vëllim të madh të aplikimeve nga Kosova.

⁹⁵ Banka Botërore. Republika e Kosovës, Diagnostika Sistematike e Vendit (2017). Burimi <https://bit.ly/37AYr39>

⁹⁶ Martin Dimitrov. Migrantët nga Ballkani në Gjermani kapin shifrën 2.6 milionë. Balkan Insight (2018). Burimi: <https://bit.ly/2MZte1c>

⁹⁷ Kushtrim Sheremeti dhe të tjerët. Regjistrimi i Diasporës. Ministria e Diasporës, etj. (2017). Burimi: <https://bit.ly/2SWHUCm>

Tabela 3. Aprovimet paraprake të dhëna nga AFP për aplikimet kosovare sipas nenit 26.2 të RRBP-së dhe aprovimet e gjithmbarshme të të gjitha burimeve (përfshirë RRBP) të klasifikuar nga aktivitetet ekonomike të NACE

Profesionet		Gjithsej të para-aprovuar duke përdorur §26.2 të RRBP (2016 - Shtator 2019)	Total pre-approvals including WBR (2016 - Shtator 2019)
Të aprovuar gjithsej		64,170	77,092
A	Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	791	941
B	Minierat dhe guroret	76	85
C	Manifaktura	3,594	4,509
D	Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	18	27
E	Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhim i mbeturinave dhe aktivitetet sanuese	233	277
F	Ndërtimi	33,093	37,047
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe i motoçikletave	2,476	3,094
H	Transporti dhe ruajtja	2,002	2,345
I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	9,862	11,835
J	Informimi dhe komunikimi	117	271
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve	4	23
L	Aktivitetet me prona të paluajtshme	196	240
M	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	506	772
N	Aktivitetet administrative dhe të përkrahjes së shërbimeve	9,366	11,602
O	Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	36	74
P	Arsimi	29	63
Q	Shëndeti i njerëzve dhe aktivitetet e punës sociale	973	2,672
R	Artet, argëtimi dhe rekreacioni	104	138
S	Aktivitete të shërbimeve të tjera	629	795
T	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të padiferencuara – aktivitete prodhuese të ekonomive familjare për përdorim vetanak	65	260
U	Aktivitetet e organizatave dhe trupave ekstraterritoriale	-	3

Burimi: Agjencia Federale e Punësimit (Bundesagentur für Arbeit)

Tabela 3 tregon se nga janari 2016 deri në shtator 2019, Gjermania ka dhënë gjithsej 77,092 aprovime paraprake të aplikacioneve kosovare. RRBP-ja përbën 83 përqind të atyre aprovimeve paraprake. Profesionet që morën numrin më të madh të aprovimeve të aplikimit duke përdorur RRBP-në ishin ndërtimi, akomodimi dhe shërbimi i ushqimit, shërbimet administrative dhe mbështetëse, ndërsa profesionet që marrin aprovime më të pakta ishin financat dhe sigurimet, energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar, arsimi dhe administrata publike. Një numër i konsiderueshëm aprovimesh iu dhanë

ndërtimeve, lëmit të kujdesit shëndetësor të njeriut dhe punës sociale duke përdorur mjete të ndryshme nga RRBP-ja. Kini parasysh se jo domosdoshmërisht të gjitha aplikimet që ishin para-aprovuar morën vizë. Ambasada e Gjermanisë në Kosovë nuk i publikon të dhënat për lëshimin e vizave sipas sektorëve.

A është ky një aranzhim fitimprurës për të dyja palët, si për Gjermaninë, ashtu edhe vendet për Ballkanit Perëndimor? Apo Kosova në veçanti do ta përjetojë një ikje afatgjatë të trurit?

Kanalet e njëanshme të migracionit të punës mund të jenë kërcënim për tregjet e punës të vendeve të targetuara, pasi që ato mund të shërbejnë kryesisht për nevojat e një pale. Marrëveshjet bilaterale të bazuara në profesione dhe nivelin e shkathtësive kanë një potencial më të lartë për të arritur konceptin e “fitores së trefishtë”, ku të dyja vendet e edhe migranti mund të përfitojnë. Megjithatë, ky koncept kërkon parakushte të caktuara, siç është vlerësimi profesional i nevojave të tregut dhe furnizimi me fuqi punëtore në të dyja vendet bashkëpunuese. Agjencia Federale e Punësimit në Gjermani vlerëson dhe parashikon vazhdimisht nevojat e tregut të punës duke krijuar dhe azhurnuar një listë të profesioneve për të cilat ka mungesa si dhe duke bërë teste të tregut. Në pjesën më të madhe, bazuar në ato nevoja, AFP i aprovon ose i refuzon kërkesat e migrantëve. Nga ana tjetër, Agjencisë së Punësimit të Kosovës i mungon një analizë e ngjashme. Kosova është pjesë e politikave të ndryshme të migracionit të punës me Gjermaninë pa ndonjë specifikim të profesioneve ose niveleve të shkathtësive që korrespondojnë me nevojat e tregut të punës të Kosovës. Kosova nuk ka një listë profesionesh kundrejt së cilës do të vlerësonte se personat me cilat profesione mund të migrojnë pa e rrezikuar ikjen e trurit.

Tabela 4 paraqet indikatorët e tregut të punës të Kosovës, si numri i vlerësuar i personave të papunë, produktiviteti i punës, aprovimet totale si masë e përafërt për tendencën për të migruar, si dhe numrin e vendeve të lira të punës në Gjermani për të gjithë sektorët. Çdo profesion i renditur në tabelë ka një rrezik të vlerësuar që lidhet me të, gjë që tregon shanset që ai profesion të ndikohet negativisht nëse punëtorët vazhdojnë të migrojnë. Profesione të renditura për nga rreziku i migrimit të fuqisë punëtore të llogaritur si proporcioni ndërmjet tendencës për të migruar (gjithsej të para-aprovuara) dhe disponueshmëria e fuqisë punëtore (papunësia). Me fjalë të tjera, nëse shtylla dy tregon se për një profesion të caktuar, një numër i madh i njerëzve marrin aprovime paraprake për të migruar në Gjermani dhe Kosova ka papunësi të ulët në atë sektor (shtylla një), atëherë rreziku i migrimit në atë sektor është i lartë (shtylla e pestë) për shkak të shanseve të ulëta për të zëvendësuar migrantin nga grumbulli i të papunëve. Për shembull, shërbimet administrative dhe ndihmëse dhe ndërtimi janë ndër pesë profesione kryesore me shkallë të ulët të papunësisë në Kosovë dhe tendencë të lartë migracioni. Me supozimin për tendencat aktuale të migracionit, pesë profesione të para të renditura në Tabelën 4 mund të kenë efekt të dëmshëm në rritjen e këtyre sektorëve dhe kështu janë me rrezik të lartë. Efekti i mundshëm në PBB-së nëse këta sektorë pësojnë mungesë të fuqisë punëtore vlerësohet nga produktiviteti i punës i atij profesioni.

Nga ana tjetër, profesione të tilla si pylltaria dhe peshkimi, financat dhe sigurimet, dhe bujqësia janë ndër profesione që kanë normë të tepërt të papunësisë me shans të ulët për punësim në Kosovë në të ardhmen e afërt. Njerëzit me profesione të tilla mund të migrojnë në Gjermani përmes marrëveshjeve bilaterale me konceptin e fitores së trefishtë në mendje. Mundësimi i këtij koncepti gjatë formulimit të marrëveshjeve nënkupton identifikimin e profesioneve përplotësuese, mbrojtjen e të drejtave të migrantëve, ndarjen e kostos së migracionit (udhëtim, klasave gjuhësore, etj.), dhe hartimin e procedurave të shpejta dhe të parashikueshme të migracionit. Kanale të tilla migracioni mund ta zbusin shkallën e lartë të papunësisë në Kosovë pa dëmtuar sektorët e saj me deficit të fuqisë punëtore, t'u shërbejnë nevojave gjermane të tregut të punës si dhe të ofrojnë një mundësi më prosperuese për migrantin.

Tabela 4. Të dhënat për tregun e punës bazuar në profesionet dhe të renditura sipas rrezikut të migrimit nga Kosova⁹⁸

Profesionet	Nr. i vlerësuar i të papunëve në Kosovë 2018	Gjithsej para-aprovime të miratuara nga AFP 2018 (për person)	Produktiviteti i punës në Kosovë 2018 (Euro)	Vende të lira të punës në Gjermani në 2019	Rreziku nga migrimi i punës (sa më e lartë %, më i lartë rreziku) ⁹⁸
1 Aktivitetet administrative dhe të përkrahjes së shërbimeve	925	2,071	4,489	260,212	224%
2 Minierat dhe guroret	0	12	47,457	789	100%
3 Aktivitetet me prona të paluajtshme	0	47	1,256,586	7,560	100%
4 Ndërtimi	13,049	6,226	13,519	139,352	48%
5 Shëndeti i njerëzve dhe aktivitetet e punës sociale	1,336	615	6,213	189,150	46%
6 Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	4,829	2,080	3,467	88,925	43%
7 Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	514	174	15,924	101,790	34%
8 Informimi dhe komunikimi	411	92	10,150	55,706	22%
9 Arsimi	103	16	6,455	41,970	16%
10 Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhim i mbeturinave dhe aktivitetet sanuese	411	59	11,067	6,103	14%
11 Manifaktura	7,500	960	20,330	147,370	13%
12 Transporti dhe ruajtja	3,699	422	21,526	92,265	11%
13 Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	411	19	21,572	24,042	5%
14 Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe i motoçikletave	28,255	595	14,615	140,946	2%
15 Aktivitete të shërbimeve të tjera	14,795	148	785	32,469	1%
16 Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve	1,233	7	32,767	20,232	1%
17 Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës	5,856	66	0	0	1%
18 Artet, argëtimi dhe rekreacioni	3,904	16	5,868	11,059	0%
19 Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	54,865	109	42,592	13,389	0%
20 Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	1,849	7	35,404	2,970	0%
21 Të tjera	822	3	0	0	0%
Mospërputhja	205	0			
Gjithsej	144,972	13,744			

Burimi: Numri i personave të papunë në Kosovë 2018 është marrë nga Anketimi i Forcës së Punës të ASA-së ndërsa përqindja e ndarjes së të papunëve në profesionet e NACE u llogarit duke përdorur të dhëna nga sondazhi i MCC.⁹⁹ Kontratat e para-aprovuara të punës nën RRBP 26.2 gjatë vitit 2018 ishin porositur sipas pranë Agjencisë Federale të Punësimit (Bundesagentur für Arbeit). Produktiviteti i punës në Kosovë është llogaritur duke përdorur të dhënat e ASK-së për PBB-në dhe punësimin.¹⁰⁰ Numrat e vendeve të lira të punës në Gjermani 2019 i referohen të dhënave nga Eurostat.¹⁰¹

98 “Rreziqet nga migrimi i fuqisë punëtore” ishte përllogaritur duke e pjesëtuar shtyllën “Numri i të papunëve në Kosovë 2017” me shtyllën numri i “Kontratave të punës të para-aprovuara sipas 26.2 gjatë 2018” në Tabelën 5.

99 Avni Kastrati dhe të tjerët. Anketa e Fuqisë Punëtore 2018. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2019).

Burimi: <https://bit.ly/36yaiox>

Korporata e Sfidave të Milienumit (MCC). Kosovë- Fuqia Punëtore dhe Anketa mbi Shfrytëzimin e Kohës.

Madhësia e mostrës së personave të papunë ishte 1,411, që konsiderohet përfaqësuese e popullatës së papunë.

Burimi: <https://bit.ly/2FzUwzl>

100 Fatmir Morina dhe të tjerët. Prodhimi i Brendshëm Bruto (GDP) për Kosovën 2008-2018. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (2019). Burimi: <https://bit.ly/2ZC7hKT>

101 Eurostat. Statistikat e vendeve të lira të punës sipas NACE Rev. 2 activity – të dhënat tremujore.

Duhet të bëhet një dallim i rëndësishëm në kategorinë e kujdesit shëndetësor të njerëzve dhe punës sociale. Sipas Odës së Mjekëve të Kosovës, më shumë se 600 mjekë janë të papunë, 60 prej të cilëve janë specialistë,¹⁰² dhe megjithatë ata pretendojnë se Kosova duhet të hapë 5,000 poste të reja në mënyrë që të përmbush nevojën aktuale. Kështu që, Kosova mund të ketë një tepricë të infermierëve, por deficit sa i përket mjekëve dhe specialistëve.

Të dhënat e tregut të punës të paraqitura në Tabelën 4 ilustrojnë papunësinë e përgjithshme gjatë vitit 2018, ndërsa ndarja në profesionet e NACE-s u vlerësua duke përdorur të dhëna të Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) nga viti 2017. Të dhënat e fundit në lidhje me tregun e punës në Kosovë nuk janë mbledhur siç duhet dhe kjo shpesh çon në matje të vonuar. Prandaj, ky studim nuk përpiket të vlerësojë rrezikun nga migracioni, por thjesht jep një pasqyrë të përgjithshme se ku ekziston rreziku dhe mundësitë potenciale. Për më tepër, Tabela 4 nuk e trajton nivelin e shkathtësive (kualifikimeve) të migrantëve. Me fjalë të tjera, nuk është në gjendje të tregojë nëse personat që migrojnë janë të kualifikuar ose nëse zëvendësimi i tyre i mundshëm nga grupi profesional i papunë përputhet me nivelin e shkathtësive të atyre që migrojnë. Vlerësimet adekuate duhet të bëhen nga Agjencia e Punësimit e Kosovës.

Përfundimi dhe rekomandimet

Gjermania ka shkallën e saj më të ulët të papunësisë dhe numrin më të madh të vendeve të lira të punës që nga vitet 1980-ta, ndërsa kostoja e vendeve të paplotësuar të punës është rritur me shpejtësi. Si përgjigje ndaj kësaj, Gjermania ka prezantuar ligjin e saj më liberal për imigracionin deri më sot si dhe ka krijuar një rregullore të veçantë që u jep qytetarëve të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor qasje preferenciale në tregun e punës, pavarësisht nga niveli i shkathtësive. Sidoqoftë, pak analiza janë bërë se si kërkesa e Gjermanisë për fuqi punëtore do të ndikonte në ekonominë dhe tregun e punës në ato vende.

Kosova ka shkallën më të lartë të papunësisë në Ballkanin Perëndimor dhe imigracionin më të lartë përmes Rregullores Gjermane për Ballkanin Perëndimor. Për shkak të sistemit arsimor që nuk reflekton nevojat e tregut si dhe për shkak se ka krijuar një mospërputhje të shkathtësive, Kosova ka deficit të fuqisë punëtore në disa fusha dhe ka tepricë në të tjerat. Për dallim nga Gjermania, Kosova nuk ka listat e profesioneve që janë shumë të kërkuara ose profesione që ballafaqohen me papunësi të lartë. Përkundër kësaj, Kosova është përfshirë në politikat e njëanshme të Gjermanisë pa specifikime të shkathtësive/profesioneve, siç janë RRBP-ja dhe Programi i Partneritetit i Shkathtësive (Kualifikimeve). Nëse vazhdohet me këtë trend të migracionit të fuqisë punëtore, Kosova rrezikon rritjen e deficitit të saj sektorial të fuqisë punëtore.

Në këtë punim jemi përpjekur të hidhnim dritë se cilët sektorë do të ishin përplotësues për të dyja tregjet e punës dhe cilat mund të paraqesin rrezik për Kosovën. Aty gjithashtu shpjegohet gjendja e ligjeve aktuale për migracionin nga Kosova për në Gjermani, që nuk e mbështet domosdoshmërisht konceptin e fitores së trefishtë. Problemet kryesore përfshijnë ikjen e mundshme të trurit nga vendet e targetuara, kohën e ngadalshme të procesimit që prek si ekonominë, ashtu edhe migrantët, si dhe kostot larta të aplikimit.

Gjetjet sugjerojnë që bujqësia, pylltaria dhe peshkimi, financat dhe sigurimet janë ndër sektorët që paraqesin rrezik të ulët për sa i përket rritjes së vogël në Kosovë dhe që kërkohen nga Gjermania. Migrimi i kosovarëve brenda lëmit të kujdesit shëndetësor ndaj njerëzve dhe punës sociale paraqesin rrezik të moderuar për Kosovën dhe janë mjaft të kërkuara në Gjermani. Brenda kësaj kategorie, mjekët dhe

Burimi: <https://bit.ly/2SrAKW5>

102 Ariana Kasapolli – Selani. Papunësia e rrit interesimin e mjekëve për ta lëshuar Kosovën. Radio Evropa e Lirë (2020). Burimi: <https://bit.ly/3b5qBFJ>

specialistët janë më të nevojshëm sesa infermierët në Kosovë. Në të njëjtën kohë, shërbimet administrative dhe ndihmëse dhe ndërtimi janë ndër sektorët ku mund të paraqiten rreziqe të mundshme në Kosovë. Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknologjike dhe sektori i TIK-ut janë veçanërisht të prirë ndaj rreziqeve për shkak të migracionit, duke pasur parasysh produktivitetin e tyre të lartë në Kosovë, furnizimin e ulët me fuqi punëtore dhe perspektivat në rritje të migracionit përmes ligjit të ri, Ligji për Imigracionin e Kualifikuar.

Për shkak të mungesës së të dhënave publike të përshtatshme për tregun e punës në Kosovë, ky punim u mbështet në matjet e vonuara. Duke qenë dëshmitar të migracionit të lartë të fuqisë punëtore nga Kosova dhe kanalet e ardhshme të migracionit ligjor me Gjermaninë, Instituti GAP rekomandon:

Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK) duhet të vlerësojë dhe parashikojë siç duhet nevojat e tregut të punës në Kosovë. Për ta bërë këtë, APK-ja duhet të mbledhë të dhëna gjithëpërfshirëse për vendet e lira të punës dhe sfondin profesional dhe arsimor të të papunëve. Ajo duhet të kryejë anketa të rregullta/periodike me bizneset ose shoqatat e biznesit në lidhje me nevojat aktuale dhe të parashikuara të punës. Bashkëpunimi me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, agjencitë lokale të punësimit, OJQ-të dhe odat e tregtisë është thelbësor për të siguruar rezultate të shpejta dhe me kosto efektive.

Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS) në Kosovë duhet t'i përdor të dhënat nga APK-ja për të hartuar politikat e migracionit të fuqisë punëtore në përputhje me nevojat e tregut të punës. Për më tepër, kur lidhen marrëveshje bilaterale të migracionit, MPMS-ja duhet t'i mbrojë të drejtat e migrantëve, të ndajë koston e migracionit të punës (udhëtimi, kurset gjuhësore, etj.), dhe të hartojë procedura të shpejta dhe të parashikueshme të migracionit. Marrëveshjet e punës sezonale mund të shihen si një mundësi për profesionet ku Kosova ka shkallë të ulët të papunësisë.

Qeveria e Kosovës duhet t'i mbështesë ndërmarrjet kosovare për të krijuar degë në Gjermani dhe në vendet e tjera të BE-së për të marrë përsipër punë në ato vende duke punësuar njerëz me kualifikime të larta ose me kualifikime të ulëta nga Kosova.¹⁰³ Pastaj vendimi i ashtuquajtur Van der Elst do të lejonte që punonjësit e këtyre kompanive të regjistruara në një vend të BE-së të punonin edhe në vendet e tjera të BE-së mbi baza të përkohshme ("dërgimi").¹⁰⁴ Teprica e fuqisë punëtore e Kosovës duhet të shndërrohet në një aset për bizneset e Kosovës për të marrë projekte në vendet ku ka një deficit të punës ose për të tërhequr Investimet e Huaja Direkte (IHD). Qeveria e Kosovës duhet të hartojë një plan ose një strategji për të zvogëluar emigrimin e atyre nga profesionet që kanë deficite të fuqisë punëtore dhe produktivitet të lartë. Strategjia duhet të sjellë stimuj të ndryshëm siç janë grantet për bizneset fillestare (start-up) dhe/ose masa të tjera të politikave që do ta mbajnë fuqinë punëtore në Kosovë.

Qeveria e Gjermanisë duhet të rrisë kapacitetin e ambasadës së saj në Prishtinë. Prej vitit 2017 deri në vitin 2018, vetëm dy anëtarë shtesë të stafit i janë bashkuar ambasadës, ndërsa numri i aplikimeve është rritur me shpejtësi.¹⁰⁵ Plotësimi me staf, si dhe metodologjitë e duhura (për përzgjedhjen dhe verifikimin e migrantëve) mund ta zvogëlojnë kohën e procesimit që aktualisht është e paqëndrueshme. Më tej, duhet të hetohet nëse dhe deri në çfarë shkalle. Zyra Federale e porsa-formuar për Punë të Jashtme në Berlin mund të ketë një rol në lehtësimin e përfaqësimeve të mbingarkuara gjermane në rajon, duke marrë përsipër shërbimet e vizave.¹⁰⁶

Gjatë rrjedhës së vitit 2020, Gjermania do të duhet të vendosë për zgjatjen e RRBP-

¹⁰³ Angazhimi i njerëzve nga Kosova mund të arrihet mbi bazën e rregulloreve në Ligjin për Qëndrimin dhe në Urdhëresën për Punësim, d.m.th. neni 26 par. 2.

¹⁰⁴ Misioni Gjerman në Mbretërinë e Bashkuar. Van der Elst visa (2017). Burimi: <https://bit.ly/2SgmhMy>

¹⁰⁵ Deutscher Bundestag. Vizat e punës nga Ballkani Perëndimor në 2018 (2019). Burimi: <https://bit.ly/35cp5x7>

¹⁰⁶ Ausäartiges Amt. Projektligji parasheh që Zyrës Federale për Punë të Jashtme mund t'i jepen detyra të Shërbimit të Jashtëm në procedurën e vizave. Burimi: <https://bit.ly/2UPxxBh>

së përtej datës së skadimit të saj në dhjetor 2020. Qeveria do të marrë parasysh rezultatet e vlerësimit (ende të pabotuar) të rregullores, të ndërmarra nga Instituti Gjerman për Hulumtime të Punësimit, në lidhje me faktin nëse rregullorja ka çuar në imigrim të konsiderueshëm të fuqisë punëtore, përfshirë edhe të asaj nga Kosova. Akoma dihet pak në lidhje me pasojat e kësaj politike në tregjet e punës të Ballkanit Perëndimor si dhe zhvillimin ekonomik të këtyre vendeve. Sidoqoftë, qeveria gjermane gjithashtu duhet t'i marrë parasysh këto efekte. Rezultatet e paraqitura në këtë punim sugjerojnë se RRBP-ja mund të zhvillohet më tej duke gjetur mënyra për të parandaluar një rrjedhjen e pamëshirshme të fuqisë punëtore në sektorët të cilët janë vendimtarë për zhvillimin ekonomik, gjë që mund të arrihet duke e aplikuar atë në sektorë të veçantë, ndërsa duke i përjashtuar të tjerët. Një mundësi tjetër do të ishte nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale me vendet e Ballkanit Perëndimor bazuar në shkathtësi dhe profesione nga të cilat përfitojnë tregjet e punës të të dyja palëve – si dhe t'i thuhet lamtumirë rregullimit liberal maksimal. Sido që të jetë, përfaqësuesit e Qeverisë Gjermane dhe të Agjencisë Federale të Punësimit duhet t'i koordinojnë më nga afër politikat e tyre me homologët e tyre në Kosovë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor në mënyrë që të krijojnë një situatë të fitores së trefishtë.

Shtojcat

Shtojca 1. Përmbledhje e Aktin (Ligjin) për Qëndrim të Gjermanisë (AufenthG) për aktivitete të kompensueshme

Neni 18 paragrafi 3	Leje qëndrimi e përkohshme për qëllime punësimi. Për këtë leje nuk kërkohet ndonjë kualifikim profesional.
Neni 18 paragrafi 4	Një titull qëndrimi për qëllime të punësimit që kërkon një kualifikim profesional mund të lëshohet vetëm për punësim në ndonjë profesion që është i aprovuar nga AFP-ja.
Neni 19	Një të huaji me kualifikim të lartë mund t'i jepet një leje për qëndrim të përhershëm në raste të veçanta nëse AFP-ja e ka dhënë aprovimin ose kur kjo përcaktohet me instrument ligjor të obligueshëm ose me marrëveshje ndërqeveritare që leja e qëndrimit të përhershëm mund të jepet pa aprovim nga AFP-ja.
Neni 19a	Karta Blu e BE-së lëshohet në përputhje me Direktivën e Këshillit 2009/50 / EC të datës 25 maj 2009 për shtetasit jo të BE-së për qëllime të punësimit me kualifikime të larta, ku aplikanti posedon një kualifikim të arsimit të lartë që i njihet ose që është me përvojë të gjatë profesionale dhe merr pagë të barabartë me ose tejkalon atë që i paguhet një shtetasi të kombit gjerman me pozitë të ngjashme.
Neni 19b paragrafi 1	Karta Blu e BE-së lëshohet në përputhje me Direktivën e Këshillit 2009/50 / EC të datës 25 maj 2009 për shtetasit jo të BE-së për qëllime të punësimit me kualifikime të larta, ku aplikanti posedon një kualifikim të arsimit të lartë që i njihet ose që është me përvojë të gjatë profesionale dhe merr pagë të barabartë me ose tejkalon atë që i paguhet një shtetasi të kombit gjerman me pozitë të ngjashme.
Neni 20	Një të huaji do t'i jepet leja e përkohshme e qëndrimit për qëllime hulumtimi në përputhje me Direktivën (EU) 2016/801.
Neni 21	Një të huaji mund t'i jepet leje qëndrimi e përkohshme për qëllime të vetëpunësimit, nëse (1) aplikohet një interes ekonomik ose një nevojë rajonale, (2) aktiviteti pritet të ketë efekte pozitive në ekonomi, dhe (3) i huaji ka kapital personal ose kredi të aprovuar për të realizuar idenë e biznesit.

Burimi: Ligji për Qëndrim (AufenthG)

Shtojca 2. Leje pune të dhëna dhe të refuzuara mbi pranimin e shtetasve të vendeve të treta për të punuar në përputhje me rregulloren në Nenin § 26 para. 2 Urdhëresa për Punësim (BeschV): Punësimi i shtetasve të Ballkanit Perëndimor)

	2016		2017		2018		2019 (Jan. - Shtator)		Gjithsej (2016- Shtator 2019)	
	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar
Gjithsej	42,546	11,037	74,577	19,703	46,118	10,657	46,273	9,714	209,514	51,111
A Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	734	116	1,023	221	636	70	719	45	3,112	452
B Minierat dhe guroret	21	*	89	11	57	14	76	*	243	25
C Manifaktura	2,102	429	4,162	829	2,846	518	3,054	470	12,164	2,246
D Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar	40	7	46	7	33	6	49	*	168	20
E Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhim i mbeturinave dhe aktivitetet sanuese	118	26	221	55	177	42	180	30	696	153
F Ndërtimi	20,745	5,424	31,257	8,881	15,848	4,507	16,206	3,871	84,056	22,683
G Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe i motoçikletave	1,483	603	2,785	961	1,828	593	1,866	587	7,962	2,744
H Transporti dhe ruajtja	1,963	478	5,130	1,378	4,217	739	5,376	837	16,686	3,432
I Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	5,786	1,578	11,934	2,528	8,592	1,692	8,184	1,577	34,496	7,375
J Informimi dhe komunikimi	178	33	330	115	161	54	189	33	858	235
K Aktivitetet financiare dhe të sigurimeve	22	7	26	*	82	10	155	8	285	25
L Aktivitetet me prona të paluajtshme	169	93	252	131	149	81	126	56	696	361
M Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	421	103	856	266	615	149	603	182	2,495	700
N Aktivitetet administrative dhe të përkrahjes së shërbimeve	3,957	1,501	7,382	3,206	4,088	1,443	4,276	1,321	19,703	7,471
O Administrata publike dhe mbrojtja; sigurimi social i detyrueshëm	29	5	47	*	39	*	38	3	153	8
P Arsimi	106	7	172	31	134	22	103	16	515	76
Q Shëndeti i njerëzve dhe aktivitetet e punës sociale	3,898	405	7,692	739	5,874	490	4,355	461	21,819	2,095
R Artet, argëtimi dhe rekreacioni	141	36	220	57	139	45	138	48	638	186
S Aktivitete të shërbimeve të tjera	454	144	734	205	486	157	469	133	2,143	639
T Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; mallra dhe shërbime të padiferencuara – aktivitete prodhuese të ekonomive familjare për përdorim vetanak	175	36	209	71	114	21	106	27	604	155
U Aktivitetet e organizatave dhe trupave ekstraterritoriale	4	*	10	4	3	*	5	4	22	8

Instituti GAP është një think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Block 4, Nr. 4, 10000 Pristina

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



**Rockefeller
Brothers Fund**

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga:



**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**



Këshilli i Ekspertëve i Fondacioneve Gjermane për Integrimin dhe Migracionin (SVR) është një këshill këshillëdhënës jopartiak nga nëntë ekspertë dhe ofron këshilla mbi politikën, bazuar në hulumtime dhe veprime. Me raportin e vet vjetor, Këshilli i Ekspertëve e formëson debatin publik mbi integrimin dhe migracionin në Gjermani dhe më gjerë. Njësia e Hulumtimeve e Këshillit të Ekspertëve kryen hulumtime të aplikuara me theks në edukimin e migrantëve, migracionin e detyruar dhe migracionin e punës. Gjatë punës së vet, Njësia e Hulumtimeve bashkëpunon me institutet kryesore kërkimore dhe think-tanks brenda dhe jashtë Gjermanisë. Projektet hulumtuese e plotësojnë punën e Këshillit të Ekspertëve.

www.svr-migration.de

Neue Promenade 6, 10178 Berlin, Germany

Tel.: 030. 288 86 59 – 0

info@svr-migration.de

Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani

Vlerësim i shkurtër i kthimeve
pozitive dhe negative

